



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 17/52  
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Shtetësinë.
2. Obligohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*  
**Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo unutrašnjih poslova /Ministry of Internal Affairs**

# KONCEPT DOKUMENTI PËR SHETËSINË

Përgatitur nga MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

## Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit .....	3
Hyrje.....	5
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit.....	5
Kapitulli 2: Objektivat.....	22
Kapitulli 3: Opsionet.....	23
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim.....	23
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit .....	23
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë [përcaktohet veç e veç për secilin koncept dokument].....	24
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme .....	24
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave.....	30
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi .....	31
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve .....	
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme.....	
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet.....	
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm .....	34
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin .....	
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik .....	
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore .....	
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore.....	
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore .....	

## Përmbledhje e koncept dokumentit

<b>Informacionet e përgjithshme</b>	
Titulli	Koncept Dokumenti për Shtetësi.
Ministria bartëse	Ministria e Punëve të Brendshme; Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion; Divizioni për Shtetësi.
Personi kontaktues	Liridon Neziri 038 200 19636
PSO	Fuqizimi i bazës ligjore lidhur me çështjet e migrimit, azilit dhe shtetësisë
Prioriteti strategjik	Harmonizimi i legjislacionit dhe avancimi i kapaciteteve institucionale në fushën e kontrollit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e shtetësisë.

<b>Vendimi</b>	
Çështja kryesore	Ligji aktual për Shtetësi ka dispozita të mangëta të cilat krijojnë zbrazëtira ligjore dhe interpretime me dy kuptueshmëri nga ana e nivelit qendror dhe lokal, në veçanti në çështjet e fitimit të shtetësisë.
Përmbledhje e konsultimeve	Plotësohet pas konsultimeve publike. Plotësohet pas konsultimeve publike.
Opsioni i propozuar	Ligji i ri për Shtetësi.

<b>Ndikimet kryesore të pritshme</b>	
Ndikimet buxhetore	Ky koncept dokument nuk parashihet të krijojë kosto shtesë buxhetore. Të gjitha aktivitetet e parapara do të mbulohen me ndarjet buxhetore aktuale.
Ndikimet ekonomike	Mundësia e fitimit të shtetësisë për pjesëtarët e Diasporës së Kosovës me kushte transparente, siç parashikohet në dispozitën e ndryshuar të nenit 16 të Ligjit për Shtetësinë, do të kishte ndikim për shkak të potencialit për investime nga pjesëtarët e Diasporës së Kosovës në ekonominë e Kosovës.  Zgjerimi i mundësisë për të fituar shtetësinë e Kosovës edhe për ata persona që kishin një lidhje të përshtatshme me Kosovën me lindje por që nuk kishin ruajtur vendqëndrimin e rregullt në Kosovë, ofron mundësinë e fitimit të shtetësisë për kategorinë e të rinjve, të cilët me fitimin e shtetësisë pas vendosjes së vendqëndrimit në Kosovë mund të kontribuojnë në ekonominë e Kosovës me aftësitë, ekspertizën dhe potencialin e tyre.
Ndikimet shoqërore	Ndikimi i integritit ekonomik të personave të natyralizuar duke krijuar vende të reja pune mund të ketë ndikim shoqëror përkatësisht të ndikoj në uljen e shkallës së papunësisë së të rinjve, të cilët përndryshe do të përcaktoheshin për emigrim—të ligjshëm ose të paligjshëm—jashtë vendit.
Ndikimet mjedisore	Shtetësia si status ligjor nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në mjedis. Por, përpunimi i lëndëve përkatësisht aplikimet për natyralizim me dokumente mbështetëse, humbja e aplikimeve të shtetësisë, aplikimet për regjistrimin e shtetësisë dhe nxjerrja e certifikatave të

## Koncept Dokumenti për Shtetësi

	shtetësisë kanë ndikim në mjedis për nga konsumi i letrës. Përpunimi i aplikimeve bazohet në sistemin alfanumerik i cili bazohet në letër.
Ndikimet ndër-sektoriale	Nuk pritet të ketë ndikime ndër-sektoriale por ato kufizohen vetëm në rishikimin funksional dhe ri-organizimin institucional në mbikëqyrjen dhe kontrollin nga niveli qendror në raport me Zyrat Komunale të Gjendjes Civile në fushën e shtetësisë.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Në këtë Koncept Dokument është rekomanduar zhvillimi i një strategjie afatgjatë për procesimin e lëndëve bazuar në Teknologji Informative, duke përfshirë krijimin e e-regjistrimit të popullsisë, si dhe evidentimin dhe gjurmimin e të gjitha proceseve që lidhen me shtetësinë. Zbatimi i kësaj politike të bazuar në teknologji informative pritet të ketë ndikim në ngarkesën administrative duke ofruar më shumë efikasitet dhe llogaridhënie në shqyrtimin e lëndëve dhe vendimmarrjen përkatëse.
Testi i NVM-ve	Testi i NVM-ve nuk konsiderohet relevant për fushën e shtetësisë dhe si i tillë nuk është aplikuar.

<b>Hapat e ardhshëm</b>	
Afatshkurtër	Ligj i ri për Shtetësi.

Hyrje

Figura1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Shtetësinë.
Ministria bartëse	Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Divizioni për Shtetësi.
Personi kontaktues	Liridon Neziri 038 200 19601
PSO	Fuqizimi i bazës ligjore lidhur me çeshtjet e migrimit, azilit dhe shtetësisë
Prioriteti strategjik	Harmonizimi i legjislacionit dhe avancimi i kapaciteteve institucionale në fushën e kontrollit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e Shtetësisë.
Grupi punues	Liridon Neziri – DSHAM / MPB - Kryesues; Qëndrim Bytyqi – DIEKP / MPB, zv.Kryesues; Gazmend Camaj - DSHAM / MPB, anëtar; Mërgim Himaj – DL/ MPB, anëtar; Drita Xheladini – DBF/MPB, anëtare; Rroksana Qarri – ZIP/MPB, anëtare; Venera Dibra – NJBMNJ/MPB, anëtare; Marigona Ramaj – DIEKP/MPB, anëtare; Lorik Lipoveci – Kabineti i Ministrit /MPB, anëtar; Ekrem Zeqiri – DSHAM- MPB, anëtar; Erdon Arifaj – ARC/MPB, anëtar; Nehat Pllana- Zyra Ligjore / ZKM, anëtar; Arife Gashi – SKQ/ ZKM, anëtare; Fitore Canolli – Komuna e Prishtinës; Përfaqësuesi nga Zyra e Presidentit; Drita Perezic – ICITAP, anëtare; Isah Maloku – ICITAP, anëtar; Milanka Bazder – UNHCR, anëtar; Mentor Seferi – CRPK, anëtar; Valbona Boshtrakaj – Zyra e BE-së.
Informata shtesë	Koncept Dokumenti është hartuar nga grupi punues sipas vendimit të Sekretarit të MPB-së, si dhe me mbështetje të GIZ-it, nëkuadër të Projektit ‘Përkrahje për Procesin e Integritimit Evropian të Kosovës’.

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Përkufizimit të problemit i ka paraprirë një përshkrim kronologjik i zhvillimeve në fushën e shtetësisë. Në këtë drejtim ky kapitull është ndarë në seksionet në vijim: 1). Korniza ligjore dhe institucionale në fushën e shtetësisë, 2). Kapacitetet, fushatat informuese dhe statistikat; 3). Standardet ndërkombëtare në fushën e shtetësisë dhe ndikimi i tyre në Kosovë; 4). Evoluimi i konceptit të shtetësisë në Kosovë para dhe pas

shpalljes së Pavarsisë; 5). Boshllëqet kryesore në legjislacionin përkatës në fushën e shtetësisë përfshirë edhe defektet e identifikuar në zbatim.

Koncept Dokumenti synon të paraqes një analizë gjithëpërfshirëse të zhvillimeve në fushën e shtetësisë duke u fokusuar në masat ligjore, strategjike dhe institucionale. Si i tillë, Koncept Dokumenti ofron një pasqyrë të qartë të boshllëqeve ligjore në fushën e shtetësisë në raport me zhvillimet e 12 viteve të fundit, si dhe mangësitë të identifikuar në zbatimin e legjislacionit përkatës kryesisht në nivel lokal. Koncept Dokumenti adreson një fushë mjaft komplekse siç është shtetësia e cila përkundër faktit se është drejtë ekskluzive shteteve sovraane të cilat e rregullojnë këtë fushë mbi bazë të interesit shtetëror, megjithatë duhet të jetë në frymë të traktateve ndërkombëtare dhe praktikave gjyqësore të cilat e definojnë këtë fushë sidomos në kuptim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe parandalimit të pa-shtetësisë.

Koncept Dokumenti për Shtetësi nuk lidhet me zbatimin e Acquis-it të BE-së, për shkak se kjo fushë mbetet kompetencë e shteteve anëtare, megjithatë në kuadër të përkufizimit të problemit dhe rekomandimit të masave për ndryshim janë zhvilluar analizë krahasuese me vendet të cilat kanë specifika të ngjashme (Kroacia, Sllovenia) qoftë në çështjet e suksesionit të shtetit, përkufizimit të Diasporës, etj.

#### Korniza Ligjore, Strategjike dhe Institucionale

Korniza legjislative e Republikës së Kosovës përmban norma të ndryshme juridike, ndërsa Kushtetuta e Republikës së Kosovës është akti më i lartë juridik.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Ajo pasqyron garanci të rëndësishme të cilat janë të rëndësishme edhe për konformitetin e të drejtave të individëve në lidhje me shtetësinë, fitimin dhe ruajtjen e saj. Është e rëndësishme që Kushtetuta në nenin 14 në mënyrë specifike përcakton se **fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet me Ligj**, por po aq të rëndësishëm për shtetësinë janë privilegjet e Kushtetutës të përcaktuara me nene tjera, përkatësisht:

Neni 3: Barazia para ligjit dhe fakti që Republika e Kosovës është shoqëri shumë-etnike; Neni 5: përcakton gjuhët zyrtare të Kosovës, duke përfshirë gjuhën turke, boshnjake dhe rome që do të përdoren si gjuhë zyrtare në nivelin komunal, Neni 7: përcakton vlerat, ndër të cilat respektimi i sundimit të ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimi si vlera kryesore me rëndësi edhe për çështjet që lidhen me shtetësinë gjithashtu si pjesë e ligjit bazik dhe të traktateve ndërkombëtare, të aplikueshme edhe në fushën e shtetësisë. Neni 19 i referohet aplikueshmërisë së drejtpërdrejt të traktateve ndërkombëtare, të cilat pas ratifikimit bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik, me fuqinë e zbatueshmërisë së drejtpërdrejt, kështu që parimi i epërsisë së ligjit të traktateve ndërkombëtare mbizotëron mbi ligjin e brendshëm. Në këtë drejtim, Kushtetuta në nenin 22 i renditë traktatet e mëposhtme si instrumentet thelbësore ligjore:

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollat e saj;
3. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollat e tij;
4. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
5. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave;
6. Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
7. Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Në këtë drejtim, është e qartë se zbatimi i ligjit ndërkombëtar i traktateve, parashikon gjithashtu pasqyrimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si burim i rëndësishëm për Institucionet e Republikës së Kosovës që zbatojnë legjislacionin, i cili ka ndikim në të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore.

Sa i përket korelacionit të garancive të Kushtetutës të cilat kanë ndikim edhe në fushën e shtetësisë, është e nevojshme të nënvizohen, neni 32 - e drejta për mjete juridike edhe kundër vendimeve administrative, neni 36 - E drejta e privatësisë, duke përfshirë jetën familjare dhe mbrojtjen e të dhënave, si dhe neni 41 për të drejtën për qasje në dokumente publike. Për më tepër, pas ndryshimeve Kushtetuese në vitin 2012, dispozitat specifike në lidhje me statusin e shtetësisë pas kalimit të kompetencave në Republikën e Kosovës, "dispozitat e suksesionit shtetëror", është e rëndësishme të nënvizohet se neni 155 i Kushtetutës i referohet 1) të gjithë banorëve të ligjshëm të Republikës së Kosovës në datën e miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 15 qershori 2008, të cilët kanë të drejtën për shtetësi ; ndërsa 2) njohja e të drejtës për shtetësi të Republikës së Kosovës për të gjithë shtetasit e ish RFJ-së dhe trashëgimtarët e tyre me vendbanim të përhershëm në Kosovë më 1 janar 1998, pavarësisht nga vendbanimi i tyre aktual dhe nga çdo shtetësi tjetër që ata mund të kenë, u zhvendos në Kapitullin I mbi Dispozitat Themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, statusi i shtetësisë i lidhur me suksesionin e shtetit e gëzon statusin e të drejtës kushtetuese. Prandaj, Kushtetuta si akti më i lartë juridik përmban garanci të mjaftueshme ligjore për ta mbrojtur çdo person nga praktika arbitrare ose diskriminuese kur zbaton të drejtat e parashikuara në legjislacionin për shtetësinë.

Akti kryesor ligjor që rregullon fushën e Shtetësisë, është Ligji Nr. 04/L-215 për Shtetësinë në Kosovë i cili hyri në fuqi në 2008, dhe është plotësuar me Ligjin për Shtetësinë në 2013. Baza ligjore për këtë ligj rrjedh nga neni 14 i Kushtetutës së Kosovës që përcakton se 'fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë rregullohet me ligj'. Përveç kësaj, neni 155 i Kushtetutës së Kosovës u njehtë drejtën për shtetësi të gjithë banorëve të ligjshëm në Kosovë (në datën e miratimit të Kushtetutës), si dhe të gjithë shtetasve të ish Republikës Federale të Jugosllavisë me vendbanim të përhershëm në Kosovë më 1 janar 1998. Ndërkohë, pas përfundimit të Pavarësisë së mbikëqyrur në 2012, me plotësim-ndryshimin e Kushtetutës neni 155 u zhvendos në Kapitullin I - Dispozitat Themelore.

Me synim të zbatimit të dispozitave ligjore siç përcaktohet në Ligjin për Shtetësinë, u hartuan dhe miratuan pesë (5) Udhëzime Administrative (legjislacioni sekondar):

1. Udhëzimi Administrativ nr. 05/2020 për kriteret dhe procedurat e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës;
2. Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 06/2020 për procedurën dhe kriteret e përcaktimit të statusit të personit pa shtetësi, mënyra e fitimit të shtetësisë për personin pa shtetësi dhe personin me status të refugjatit;
3. Udhëzimi Administrativ nr. 05/2017 për kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e ish-Republikës Federale të Jugosllavisë dhe banimin e përhershëm në territorin e Kosovës më 01 janar 1998;
4. Udhëzimi Administrativ nr. 06/2019 për procedurën e humbjes së shtetësisë së Kosovës me lirim dhe privim;
5. Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 03/2020 për themelimin dhe përcaktimin e rregullave të punës së Komisionit të Ankesave për Shtetësi;



## Koncept Dokumenti për Shtetësi

6. Përveç kësaj, ekziston edhe një Rregullore nr. 01/2017 e miratuar nga Zyra e Presidentit që rregullon Procedurën e Dhënies së Shtetësisë nga Presidenti për Interes të Veçantë të Republikës së Kosovës;
7. Ligji për Gjendjen Civile nr. 04/L-003 i vitit 2011, përcakton shtetësinë si komponent të statusit civil dhe përfshinë shtetësinë si të dhëna që regjistrohen në regjistrin e lindjes (neni 36/3.7).

Në lidhje me shtetësinë e Kosovës, është e nevojshme të përmendet edhe Ligji për Ripranimin (Ligji 03/2-208 i korrikut 2010) që detyron Republikën e Kosovës t'i ripranojë shtetasit e saj që banojnë jashtë vendit në rast të mos plotësimit të kushteve të qëndrimit në shtetin përkatës ku kanë emigruar: Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka përgjegjësi për të verifikuar shtetësinë e personave të cilët pritet të ripranohen, si dhe të bëjë regjistrimin e personave të ripranuar.

Në kuptim të strukturës institucionale, institucionet kryesore vijuese janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ligjore siç përcaktohet në Ligjin për Shtetësinë, Ligjin për Gjendjen Civile, Ligjin për Ripranimin dhe Marrëveshjet e Ripranimit:

- Divizioni për Shtetësi (Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion) i Ministrisë së Punëve të Brendshme: përgjegjës për përpunimin dhe procesin e vendimmarrjes për kërkesat për natyralizime mbi të gjitha bazat, lirin dhe privimin e shtetësisë;
- Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: përgjegjëse për përpunimin dhe vendosjen e kërkesave për natyralizimin e të huajve që janë me interes të veçantë të shtetit;
- Agjencia e Regjistrimit Civil (agjenci e pavarur nën Ministrinë e Punëve të Brendshme): është përgjegjëse për inspektimin e punës së zyrtarëve të gjendjes civile që veprojnë në nivelin lokal në lidhje me regjistrimin e shtetësisë në regjistrin e lindjes dhe regjistrin e shtetësisë (gjithashtu në rastin e nenit 31 dhe 32);
- Zyrat e Gjendjes Civile (Komunat): përgjegjëse për pranimin e kërkesave për natyralizim, përgatitjen e dosjes me dokumente përkrahëse, futjen e të dhënave të shtetësisë në regjistrin e lindjes, regjistrimin e shtetësisë dhe mirëmbajtjen e regjistrit të shtetësisë, për lëshimin e certifikatave të shtetësisë, për konstatimin e fakteve ligjore, duke përfshirë vendbanimin e përhershëm në datat e referencës përkatëse për regjistrimin e shtetësisë sipas neneve 31 dhe 32 të Ligjit të Shtetësisë;
- Komisioni i Ankesave: një organ i themeluar nga Ministri i Punëve të Brendshme që vendos për ankesat kundër vendimeve negative për marrjen e shtetësisë me natyralizimin ose humbjen e shtetësisë me lirim ose privim;
- Divizioni për Ripranim i DSHAM, Ministria e Punëve të Brendshme: përgjegjës për përcaktimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës për personat që janë subjekt i kthimit në Kosovë sipas marrëveshjeve të ripranimit;
- Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative: vendos për kontestet administrative kundër vendimit të Komisionit të Ankesave.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Shërbimi Konsullor: përgjegjës për parashtrimin e kërkesave për lirim nga shtetësia, dhe dorëzimin personal të vendimeve për lirim ose natyralizim, si dhe përcjelljen e kërkesave për transpozimin e regjistrimit të lindjeve dhe vdekjeve të qytetarëve të Kosovës që kanë ndodhur jashtë Kosovës dhe regjistrimi në regjistrin e qytetarëve.

Kapacitetet, fushatat informuese dhe statistikat

Sipas publikimit të UNDP/FBO i Korrikut 2019<sup>1</sup> Kosova është Shteti me popullsinë më të re në Evropë, me mbi 50% të popullsisë së përgjithshme më të re se 25 vjeç, ndërsa projekti i koordinuar nga GIZ për Krijimin e perspektivave për të rinjtë në Kosovë<sup>2</sup> (2017-2020) zbuloi se niveli i papunësisë së të rinjve është mbi 50%, që është në kontekstin e situatës së përgjithshme ekonomike në Kosovë një faktor shtytës për emigrim, ku një nga dy kosovarë dëshiron të emigrojë. Për ta trajtuar këtë çështje dhe për të siguruar orientim strategjik për zgjidhje të qëndrueshme, Qeveria e Kosovës në vitin 2018 miratoi Planin e Veprimit për Rritjen e punësimin të të rinjve<sup>3</sup> (2018-2020).

Projeksioni i Popullsisë së Kosovës<sup>4</sup> i Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregon për variant të ulët deri në vitin 2027. Rënia e popullsisë për 100.000 persona, ndërsa për vlerësimin mesëm ishte 40.000: të dhënat për shkallën e emigracionit për periudhën 2014-2015 kur normat e emigracionit arritën përqindjen më të lartë treguan se 65% e tyre ishin meshkuj, ndërsa 35% femra. Norma mesatare e fertilitetit në 2011 ishte 2,4 fëmijë për grua, ndërsa në 2016 ajo ra në 2.1 ndërsa modeli i projeksionit për vitin 2031 vlerëson se do të bjerë më tej në 1,5 fëmijë për grua. Për pjesëtimi gjinor për periudhën e përgjithshme 2017-2061 është i njëjtë, 110,5 djem për 100 vajza. Pasqyra e përgjithshme e trendeve demografike të popullsisë tregon për emigrim të qëndrueshëm gjatë gjithë periudhës.

Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë i adreson sfidat me politikat përkatëse strategjike në fushën e Migrimit, Strategjive dhe Profileve të Lehta dhe Zgjeruara të Migrimit, në kuadër të të cilave pasqyrohen të dhëna për numrin e personave të cilët kanë emigruar dhe të atyre të kthyer në vend.

Këto statistika nënvizojnë çartë rëndësinë e grumbullimit të të dhënave për objektiva të ndryshëm strategjik të shtetit. Në këtë drejtim të dhënat e sakta për shtetësinë luajnë rol të rëndësishëm edhe për planifikimin strategjik në sektorë të ndryshëm në mënyrë që të frenohen trendet negative që po e prekin popullatën e përgjithshme. Projekti i lansuar në vitin 2017<sup>5</sup> 'Forcimi i Menaxhimit të Autoriteteve të Migrimit' i përkrahur nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran dhe zbatuar nga ICMPD dhe Universiteti i Maastrichtit, ndihmoi në zhvillimin e mjeteve statistikore të cilat sigurojnë një sistem të standardizuar të mbledhjes së statistikave në fushën e migrimit, që parashikojnë emigracionin, si dhe nivelet e imigracionit. Statistikat janë të rëndësishme për procesin e vendimmarrjes sipas Strategjisë Shtetërore për Migrim 2021-2025.

Padyshim se, statistikat për shtetësinë janë relevante për programet socio-ekonomike që synojnë përmirësimin e zhvillimit ekonomik të shtetit dhe adresojnë sfidat që lidhen me pjesët më të cënueshme të popullsisë, duke qenë se personat e lënë pas si rezultat i migrimit të pakontrolluar, përkatësisht të moshuarit dhe fëmijët, ose anëtarët e grupeve etnike të zhvendosur nga lufta. Për këtë qëllim, është e rëndësishme të përmendet fushata e suksesshme e UNHCR dhe UNICEF e lansuar në 2017<sup>6</sup> e cila kishte për objektive zhvillimin e një strategjie të bashkuar për adresimin e pashtetësisë së fëmijëve që synon ç'rrenjosjen e pashtetësisë në mesin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë, për të siguruar

---

<sup>1</sup>[https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic\\_governance/social-cohesion-in-kosovo--context-review-and-entry-points.html](https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/social-cohesion-in-kosovo--context-review-and-entry-points.html)

<sup>2</sup><https://www.giz.de/en/worldwide/66634.html>

<sup>3</sup>[https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/08/Plani-i-Veprimit\\_Punesimi-i-te-Rinjeve\\_ENG-1.pdf](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/08/Plani-i-Veprimit_Punesimi-i-te-Rinjeve_ENG-1.pdf)

<sup>4</sup><https://ask.rks-gov.net/media/3741/kosovo-population-projection-2017-2061.pdf>

<sup>5</sup><https://macimide.maastrichtuniversity.nl/strengthening-migration-management-authorities-in-kosovo/>

<sup>6</sup><https://www.unhcr.org/see/where-we-work/kosovo/achievements-and-impact>

qasje të plotë në dokumentet për identitetin e tyre ligjor dhe qasjen në të drejtat që ju takojnë. Që nga viti 2008, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, kishte më shumë se 100 seanca që kishin për qëllim zhvillimin e kapaciteteve për zyrtarët komunal të gjendjes civile, autoritetet qendrore dhe gjyqtarët. Me mbështetjen e UNHCR-it dhe organizatave tjera partnere të cilat u angazhuan për lokalizimin e zgjidhjeve të qëndrueshme u themeluan dhe funksionalizuan edhe Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete. Ky veprim gjithashtu kontribuoi në lirin nga tarifat administrative për lëshimin e dokumenteve për fëmijët.

Relevanca e statusit të shtetësisë dhe mungesa e regjistrimit të saj për kategorinë e fëmijëve romë dhe ashkali u trajtua ndryshe edhe në Raportin e Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut - Raporti i shoqërisë civile për të drejtat e njeriut në Kosovë për 2019<sup>7</sup> që tregon në mënyrë specifike situatën sfiduese të këtij komuniteti, në veçanti të fëmijëve (faqe 28), Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve i miratuar në Korrik 2020 siguron bazën e duhur ligjore për zbatimin e masave për t'i mbrojtur këta fëmijë, të cilët për shkak të cenueshmërisë, lehtësisht bëhen viktimat të trafikimit të detyruar në lypje, apo edhe në prostitucion<sup>8</sup>. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023<sup>9</sup> është përgjigje e Qeverisë për sigurimin e mënyrave adekuata të bashkëpunimit ndër-institucional që do të mbrojnë fëmijët që i përkasin grupeve të cenueshme gjithashtu kundër keqpërdorimit, duke u mundësuar atyre qasje në të gjitha të drejtat të cilat ju takojnë. Për këtë qëllim, bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Divizioni për Shtetësinë, si dhe me Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe autoritetet komunale është një kusht për tejkalimin e këtyre sfidave.

#### Rëndësia e standardeve ndërkombëtare për shtetësi dhe ndikimi i tyre në Ligjin për Shtetësi të Republikës së Kosovës

**Natyrë juridike e shtetësisë në kontekstin evropian:**Edhe pse Ligji për Shtetësinë e Kosovës është në masë të madhe në pajtueshmëri me Konventat e OKB-së për Pashtetësinë, përkatësisht Konventa e OKB-së Lidhur me Uljen e Pashtetësisë (1954) dhe Konventa e OKB-së për Uljen e Pa Shtetësisë (1961), për shkak të specifikave që lidhen me shtetin pasardhës, gjithashtu është me rëndësi të analizohen dispozitat e dy instrumenteve evropiane lidhur me shtetësinë, njëra posaçërisht për shtetet pasardhëse dhe pashtetësinë.

Konventa Evropiane për Shtetësinë e Këshillit të Evropës - tani e tutje KESH (nëntor 1997)<sup>10</sup> akoma është traktati më gjithëpërfshirës për shtetësinë, më progresivi për sa i përket instrumentit ligjor që arriti të kodifikojë parimet udhëzuese, përkufizimet dhe rregullat e zbatueshme në fushën e shtetësisë. Ky traktat shtroi përkufizimin e shtetësisë (neni 2/a) i cili përcakton se "shtetësia" nënkupton lidhjen juridike midis personit dhe shtetit dhe nuk tregon prejardhjen etnike të personit, përkufizim i cili pati jehonë të fortë për demokracinë e reja që ndoqën ndryshimet dhe i dhanë formë të re hartës politike të Evropës. Në fushën e shtetësisë, ishte një nga standardet udhëzuese për ato shtete që përpiqeshin të harmonizonin legjislacionin e tyre përkatës për shtetësinë, ose të miratonin një të ri sipas standardeve të shtruar në konventën e përmendur. Lidhur me efektet juridike, nënshtetësia dhe shtetësia janë sinonime.

<sup>7</sup>[https://www.ohchr.org/Documents/Press/kosovo\\_cso\\_2019\\_human\\_rights\\_report\\_en.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Press/kosovo_cso_2019_human_rights_report_en.pdf)

<sup>8</sup><https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>

<sup>9</sup><https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/40542-UpdEn.pdf>

<sup>10</sup><https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/166>

Për shtetet e reja të cilat u shfaqën pas shpërbërjes ose shpërbërjes nga një shtet i mëparshëm, në Këshillin e Evropës janë zhvilluar standardet specifike që mbulojnë çështjen e pashtetësisë në lidhje me shtetin pasardhës, gjithashtu në formë të një Konvente të Këshillit të Evropës për shmangien e pa-shtetësisë në lidhje me shtetin pasardhës<sup>11</sup>, traktati i cili përcaktonte parimet për evitimin e pa shtetësisë dhe rregullat specifike për përgjegjësinë e shtetit pasardhës, dhe përgjegjësinë e shtetit paraardhës në rast të pa shtetësisë. Këto dy traktate janë gurthemel që duhet të pasqyrohen në legjislacionin e Shteteve Evropiane "që rregullojnë shtetësinë, pavarësisht faktit nëse ato i kanë ose nuk i kanë ratifikuar traktatet - të dy parashohin faktin të përfshijnë parimet e instrumenteve të detyrueshme ndërkombëtare, përkatësisht Konventat e OKB-së lidhur me Statusin e Personave Pashtetësi dhe Uljen e Pashtetësisë. Sipas përkufizimit të të "drejtës së brendshme" të KESH, neni 2 / d, nënkupton të gjitha llojet e dispozitave të sistemit juridik kombëtar, përfshirë kushtetutën, legjislacionin, rregulloret, dekretet, praktikën gjyqësore, rregullat zakonore dhe praktikën, si dhe rregullat që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare.

KESH në nenin 3 përcaktoi gjithashtu një parim të përgjithshëm të rëndësishëm: parimi i Kompetencës së Shtetit (Fuqia e Shtetit) ku secili shtet sipas ligjit të vet gëzon të drejtën për të përcaktuar se kush janë shtetasit e tij, ndërsa ky pushtet kufizohet nga pranimi nga shtetet e tjera, përderisa është në përputhje me konventat e zbatueshme ndërkombëtare, të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe parimet e së drejtës përgjithësisht të njohura lidhur me shtetësinë. Parime të tjera të zbatueshme të parashikuara në nenin 4 përcaktojnë: a) e drejta e secilit për shtetësi, b) evitimi i pashtetësisë, c) askush nuk privohet arbitrarisht nga shtetësia e saj/tij, d) as martesë as shpërbërja e martesës midis një shtetasi të një Shteti Palë dhe një të huaji, ose ndryshimi i shtetësisë nga një prej bashkëshortëve gjatë martesës, ndikon automatikisht në shtetësinë e bashkëshortit tjetër.

Mos-diskriminimi (neni 5) ndalon rregullat për shtetësinë që përmbajnë dallime ose përfshijnë çfarëdo praktike që shpie te diskriminimi për shkak të gjinisë, fesë, racës, ngjyrës ose origjinës kombëtare ose etnike. Çdo shtet duhet të udhëhiqet nga parimi i mos diskriminimit midis shtetasve të tij, pavarësisht nëse ata janë shtetas nga lindja ose rrjedhimisht kanë fituar shtetësinë.

Shtetet që pranojnë parimet e përmendura në këtë mënyrë pranojnë gjithashtu parimet dhe rregullat për shtetësinë të përfshira në instrumentet juridike universale, përkatësisht neni 15 i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut<sup>12</sup> (e drejta e çdo personi në shtetësi), neni 7 i Konventës së KB për të Drejtat e Fëmijëve<sup>13</sup>(fëmija ka të drejtë të regjistrohet menjëherë pas lindjes, të marrë shtetësinë dhe të drejtë në emër); detyrimi për të shmangur pa shtetësinë është bërë pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe Konventës së vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë<sup>14</sup>, përcakton rregullat për zbatimin e saj, ndërsa për të harmonizuar zbatimin e rregullave midis shteteve, Udhëzimet për Pashtetësinë Nr.4 për nenin 1 - 4<sup>15</sup> (Dhjetor 2012), si dhe Udhëzimet për Pashtetësinë Nr. 5 për humbjen dhe privimin e shtetësisë sipas nenit 5-9 (Maj 2020)<sup>16</sup> të Konventës për Uljen e Shtetësisë. Së bashku me traktatet e OKB-së për eliminimin e diskriminimit, traktati kornizë i zbatueshëm në Evropë, paraqet pjesë të fuqishme të

<sup>11</sup><https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/200>

<sup>12</sup><https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

<sup>13</sup><https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

<sup>14</sup>[https://www.unhcr.org/ibelong/wp-content/uploads/1961-Convention-on-the-uction-of-Statelessness\\_ENG.pdf](https://www.unhcr.org/ibelong/wp-content/uploads/1961-Convention-on-the-uction-of-Statelessness_ENG.pdf)

<sup>15</sup>[https://www.un.am/up/library/Guidelines%20on%20Statelessness%20No%204\\_eng.pdf](https://www.un.am/up/library/Guidelines%20on%20Statelessness%20No%204_eng.pdf)

<sup>16</sup><https://reliefweb.int/report/ëorld/guidelines-statelessness-no5-loss-and-deprivation-nationality-under-articles-5-9-1961>

parimeve dhe rregullave që duhet të pasqyrohen në legjislacionin kombëtar, dhe mbi të gjitha, zbatimin e tij.

Pavarësisht faktit se Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore<sup>17</sup> krahasuar p.sh.me Konventën Amerikane për të Drejtat e Njeriut<sup>18</sup> nuk e vendos të drejtën në shtetësi si e drejtë njerëzore, praktika progresive e gjykatave ndërkombëtare, në veçanti Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton praktikën gjyqësore e cila thekson çartë faktin se parimet e së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht ndalimi i diskriminimit, shmangia e pashtetësisë kundrejt të drejtës për shtetësi, e drejta për privatësi dhe për këtë qëllim e drejta për jetën familjare, janë standardet që duhet të pasqyrohen në legjislacionin përkatës që rregullon shtetësinë, ndërsa në nivelin individual, në rast të shkeljes së parimeve, individët kanë të drejtë për dëmshpërblim të drejtë.

Këto garanci, posaçërisht gëzimin e së drejtës në jetë private dhe jetë familjare<sup>19</sup> kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në vendimet për shtetësinë, në vakumin ligjor në legjislacionin përkatës për shtetësinë, si dhe në zbatimin e gabuar të vetë ligjit. Ndikimi i praktikës gjyqësore në lidhje me praktikën e shtetit pasardhës (rasti i shpërbërjes së ish RSFJ-së Kurić dhe të tjerët kundër Sllovenisë<sup>20</sup>), si dhe për pashtetësinë dhe ndikimin e privimit të shtetësisë në jetën private (rasti Karassev kundër Finlandës<sup>21</sup>, rasti Genovese kundër Maltës<sup>22</sup>, rasti Ramadankundës Maltës<sup>23</sup>, rasti K2 kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>24</sup> dhe të tjerët) është një burim i rëndësishëm i së drejtës për autoritetet me mandat për çështjet e shtetësisë, si dhe për individët të cilëve u janë shkelur të drejtat.

Shtetësia, megjithëse nuk është e renditur në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) si e drejtë e njeriut në vetvete dhe ndërlidhja e saj me të drejtat e tjera të mishëruara në KEDNJ dhe Protokollat përkatëse, është pra e drejta që renditet si e drejtë personale: kufizon shtetin dhe pushtetin e tij nga aktet që mund të çojnë në vendime arbitrare dhe diskriminim, pra është një e drejtë ekskluzive e parimit themelor të shoqërisë demokratike: sundimi i së drejtës. Për sa i përket pronësisë mbi të drejtën e privatësisë, është e çartë, se kjo e drejtë i përket individit dhe shteti me rendin e vet juridik është i detyruar ta mbrojë atë.

Në këtë drejtim, është e rëndësishme t'i referohemi grafikut të veçantë të të drejtave të garantuara çdo fëmije sipas Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, përkatësisht gjithashtu neni 8/2, i cili përcakton detyrimin e shtetit për të vepruar shpejt në secilin rast kur cilido fëmijë në mënyrë të paligjshme është privuar nga disa ose të gjitha elementet e identitetit të saj/tij ose/dhe të ofrojnë ndihmë për t'ia rikthyer identitetin. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të përmendet angazhimi i përgjithshëm i bashkësisë ndërkombëtare, siç përcaktohet në Qëllimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm, 16/9,<sup>25</sup> që deri në vitin 2030 të sigurojë identitet ligjor për të gjithë, përfshirë regjistrimin në lindje.

---

<sup>17</sup>[https://www.echr.coe.int/documents/convention\\_eng.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf)

<sup>18</sup><https://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%201144/volume-1144-i-17955-english.pdf>

<sup>19</sup>[https://www.echr.coe.int/documents/guide\\_art\\_8\\_eng.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/guide_art_8_eng.pdf)

<sup>20</sup><https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22%3A%22001-111634%22%7D>

<sup>21</sup><https://www.refworld.org/cases,ECHR,45d076a92.html>

<sup>22</sup><http://hudoc.echr.coe.int/fre?i=001-106785>

<sup>23</sup><https://www.refworld.org/cases,ECHR,57ff5080ae3.html>

<sup>24</sup><https://www.statewatch.org/media/documents/news/2017/mar/uk-echr-terrorism-deprivation-citizenship-art-8-judgment-pr-9-3-17.pdf>

<sup>25</sup><https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf>

Për këtë qëllim është e rëndësishme që korniza e përgjithshme legislative që mbulon shtetësinë e një shteti përkatës, të jetë në përputhje edhe me zhvillimet praktikës gjyqësore të gjykatave ndërkombëtare.

#### Evolucioni i konceptit të shtetësisë së Republikës së Kosovës para shpalljes së Pavarësisë

Para shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, përkatësisht nga viti 1999 kur autoritetin në territorin e Kosovës e kishte UNMIK-u, statusi i shtetësisë së Republikës së Kosovës nuk ekzistonte. Në vend të kësaj, të drejtat që kishin të bënin me shtetësinë dhe statusi i popullsisë rregullohej me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/13 për Regjistrin Qendror Civil<sup>26</sup> duke shtrirë statusin e banorëve të përhershëm të Kosovës në kategoritë e popullsisë të cilët mund të siguronin prova se ishin pasardhës të së paku një paraardhësi, ose që kishin qëndruar për të paktën pesë vjet, me përjashtim të personave që kanë qenë të detyruar të largohen nga territori si refugjatë.

Sidoqoftë, norma e përmendur nuk është zhvilluar vetëm për t'i siguruar popullsisë dokumente identiteti. Duke pas parasysh faktin që burimi kryesor i provave për identitetin ligjor (librat amzë) ishin marrë dhunshëm dhe dërguar në Serbi, kështu që provat nuk ishin të arritshme për popullatën, në anën tjetër administrata e përkohshme ndërkombëtare (UNMIK) kishte përgjegjësi të organizonte zgjedhjet e para lokale që krijuan komunat si burim i pushtetit demokratik në nivelin lokal, dhe në këtë drejtim, regjistri i sapo krijuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 13/2000 u përdor për krijimin e listës së zgjedhësve për zgjedhjet lokale tetor 2000<sup>27</sup>, megjithëse Rregullorja supozohej të mbulonte nevojat e popullsisë, përfshirë edhe për ata që nuk kishin të drejtë vote (të miturit) dhe të siguronin dokumentet e identitetit për këtë kategori.

**Kalimi i banorëve të përhershëm të Kosovës në shtetësinë e Kosovës pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 2008: organi fillestar i shtetësisë:** Kosova shpalli Pavarësinë më 17 shkurt 2008<sup>28</sup>, ndërsa më 20 shkurt

2008 hyri në fuqi Ligji për Shtetësinë<sup>29</sup>. Ligji u bazua në standarde ligjore përparimtare lidhur me kushtet për marrjen dhe humbjen e shtetësisë, të harmonizuara me shumicën e parimeve të Konventës Evropiane për Shtetësinë: ligji parashihte parimin e dy shtetësisë dhe kështu kontribuoi në zvogëlimin e rasteve të pashtetësisë që ndërlidheshin me fitimin e shtetësisë nga lindja ose natyralizimi: parimi themelor i marrjes së shtetësisë në lindje është *jussanguinis*, ndërsa *jus soli* kryesisht kufizohet në rastet kur fëmija i posalindur mund të jetë në rrezik të pashtetësisë (lindja e fëmijës nga prindërit që janë pa shtet ose të panjohur).

Sidoqoftë, pjesa e ligjit të dispozitat kalimtare, sipas dispozitave 28 dhe 29 (pas ndryshimit të ligjit, tani dispozitat 31 dhe 32) që mbulon shtetin pasardhës nuk është plotësisht në përputhje me parimet e përgjithshme për shtetin pasardhës të mishëruara në nenin 18 të KESH (hyri në fuqi në nëntor 1998), veçanërisht në lidhje me vullnetin e personit në fjalë, si dhe parimin e lidhjes efektive dhe të mirëfilltë të personit në fjalë me shtetin: mundësia e natyralizimit të lehtësuar e pjesëtarëve të Diasporës së Kosovës siç përcaktohet në nenin 13 (më vonë 16) ofron mundësi për fitimin e shtetësisë së Kosovës për ata persona, të cilët nuk janë të mbuluar me dispozitat e neneve 31 dhe 32, të cilat pas ndryshimit të Kushtetutës në 2012 kanë natyrën e dispozitës kushtetuese, rrjedhimisht edhe nivelin më të lartë të garancisë ligjore. Zgjidhja nuk është as në përputhje me rregullat dhe parimet konkrete të Konventës së

<sup>26</sup>[https://data.globalcit.eu/NationalDB/docs/KOS%20UNMIK\\_Regulation\\_on\\_Civil\\_Registry\\_2000%5B1%5D.pdf](https://data.globalcit.eu/NationalDB/docs/KOS%20UNMIK_Regulation_on_Civil_Registry_2000%5B1%5D.pdf)

<sup>27</sup><https://rm.coe.int/168071a3cf>

<sup>28</sup><https://www.refworld.org/docid/47d685632.html>

<sup>29</sup><https://aceproject.org/ero-en/regions/europe/KS/law-no.-03-l-034-on-citizenship-of-kosova-20/view>

Këshillit të Evropës për Shmangjen e Pashtetësisë në lidhje me shtetin pasardhës - 9, (Maj 2009) domethënë neni 5: Përgjegjësia e shtetit pasardhës i cili në paragrafin 1 përcakton detyrimin t'u japë shtetësinë e saj personave, të cilët në kohën e shtetit pasardhës, kishin shtetësinë e shtetit paraardhës dhe të cilët do të bëheshin pa shtetësi si rezultat i shtetit pasardhës nëse në atë kohë: ata nuk ishin banorë të përhershëm të ndonjë shteti në fjalë, por kishin një lidhje të përshtatshme me shtetin pasardhës, në përputhje me paragrafin 2. Një lidhje e përshtatshme përfshin, në mes tjerash, (2 / b) - lindja në territorin i cili është bërë territor i shtetit pasardhës ose ka pasur vendbanimin e fundit të përhershëm në territorin e shtetit paraardhës i cili është bërë territori i shtetit pasardhës. Respektimi i vullnetit të personit në fjalë mbulohet nga neni 7-dhe përcakton detyrimin e shtetit pasardhës të mos refuzojë t'i japë shtetësinë e tij personit i cili do të plotësonte kriterin e kushteve të mëparshme (neni 5 / 2-) për arsyet, që një person mund të marrë shtetësinë e një shteti tjetër në fjalë.

Rregullat e përmendura janë zhvilluar duke u bazuar në raste praktike që janë identifikuar nga shtetet që morën pjesë në përpunimin dhe miratimin e traktatit, në bashkëpunim me UNHCR. Rregullat janë zhvilluar me qëllim për të zvogëluar në minimum boshllëqet në legjislacionin e shteteve të reja që u shfaqën pas shteteve pasardhëse dhe do të ishin pa shtetësi, kryesisht në rastin e ish RSFJ-së dhe ish BRSS-së.

Për shkak të konflikteve në vitet 90, këto situata kanë çuar në shumicën e rasteve të pashtetësisë me popullatë të zhvendosur, duke qenë de facto, apo edhe de jure. Rregullat janë zhvilluar me qëllim që të përdoren nga shtetet që kanë nevojë të zgjidhin çështjet që kanë të bëjnë me shtetin pasardhës dhe të cilat mund të shpien deri në pashtetësi. Në të vërtetë, në lidhje me detyrimet nga traktati, ato nuk kanë efekt prapa veprues. Por ky fakt nuk e ndalon shtetin të përdorë rregullat si mekanizëm të dobishëm për të plotësuar boshllëkun që akoma mund të ekzistojë në legjislacionin që mbulon shtetësinë. Përkundrazi, mund të përdoret si argument ligjor që justifikon ndryshimin elegjislacionit.

Zgjidhja kalimtare e përdorur në Ligjin për Shtetësinë është "importuar" nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/13, e cila është pasojë e një fakti objektiv, duke pasur parasysh rrethanat specifike të procesit të përgjithshëm dhe të ndërlikuar politik i cili çoi në shpalljen e Pavarësisë në 2008. **Neni 32** mbulon gjithashtu edhe banorët e Kosovës, të cilët kishin vendbanimin e përhershëm më 1 Janar të vitit 1998 në Kosovë dhe ishin qytetarë të RFJ-së, duke u dhënë atyre shtetësinë e Republikës së Kosovës, me kusht që ata të regjistrohen nëse kanë qenë të regjistruar në librin amë të qytetarëve, pavarësisht nga vendi i vendbanimit ose shtetësisë së tyre aktuale. Organi kompetent përdorë kriteret e UNMIK-ut nga Rregullorja 2000/13 për të përcaktuar vendbanimin e përhershëm në Kosovë më 1 janar 1998.

Institucioni primar i shtetësisë i Republikës së Kosovës është bazuar në parimin territorial dhe nuk e parasheh parimin e origjinës, siç është rasti i të gjithë shteteve pasardhëse të ish RSFJ-së; parimi i vazhdimësisë së ish-shtetësisë së republikës që u fitua në përputhje me ligjet që rregullonin fitimin dhe humbjen e shtetësisë para hyrjes në fuqi të ligjit të ri për shtetësinë e një shteti të pavarur të kthyer në shtetësinë e shtetit të ri, i cili zëvendësoi ish Republikën si shtet i pavarur. Disa shtete përveç parimit të përmendur ligjor, kanë siguruar bazë ligjore për fitimin e shtetësisë për qytetarët e republikave të tjera me qëndrim të përhershëm në territorin e tyre (p.sh. Republika e Sllovenisë përcaktoi kushtin e përgjithshëm: vendbanimi përhershëm i regjistruar më 23 dhjetor 1990 (data e referendumit për pavarësi), të ketë jetuar në territorin e Sllovenisë dhe të kishin aplikuar për shtetësi brenda periudhës kohore 23 dhjetor 1991. Ky rregull është ndryshuar më vonë në dhjetor të vitit 1991 duke përjashtuar ata që kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në agresion të armatosur kundër Republikës së Sllovenisë. Në rastin e Maqedonisë së Veriut, ligji mundësoi marrjen e lehtësuar të shtetësisë për ata që ishin banorë të

përhershëm dhe që kishin jetuar në Maqedoni për të paktën 15 vjet dhe kishin mjete të mjaftueshme për të mbajtur veten. Republika e Kroacisë nuk siguroi rregulla specifike për marrjen e shtetësisë për banorët me shtetësi të republikës tjetër, ndërsa në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, Ligji për Shtetësinë e vazhdoi shtetësinë e Republikës për të gjithë personat të cilët kanë qenë banorë të përhershëm në 6 Prill të vitit 1992, pavarësisht vullnetit të tyre.

Mangësitë kryesore në zbatimin e kornizës legislative:

Ligji për Shtetësinë i Republikës së Kosovës së bashku me pesë udhëzime administrative për zbatimin e tij (UA për Kriteret dhe Procedurat për Marrjen e Shtetësisë së Republikës së Kosovës-05/2020; UA për Kriteret dhe Procedurat e Përcaktimit të Statusit të Personave Pa Shtetësi; Mënyra e Marrjes së Shtetësisë nga Personat Pa Shtetësi dhe me Status të Refugjatit; 06/2020-UA rreth Krieteve që Përmbajnë Prova për Shtetësinë e Republikës Federative të Jugosllavisë dhe banim të përhershëm në territorin e Kosovës më 1 janar 1998, 07/2017; UA për Procedurën e Humbjes së Shtetësisë së Kosovës nga Lirimi ose Privimi; 06/2019, UA për Vendosjen dhe Përcaktimin e Rregullave të Punës për Komisionin për Ankesa mbi Shtetësinë), në kuptimin e masave mbrojtëse të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës gjithashtu në kuptim të faktit të epërsisë së të drejtës dhe traktateve ndërkombëtare kundrejt të drejtës vendore, përgjithësisht janë në përputhje me standardet e zbatueshme ndërkombëtare në sferën e shtetësisë dhe praktikën ekzistuese shtetërore.

Sidoqoftë, qëndrueshmëria e nenit 32 me specifikat nën parimet e shtetit pasardhës mund të mos kënaqë provën e mundshme në Gjykatë, veçanërisht në lidhje me faktin, se ekziston praktika gjyqësore për shtetet pasardhëse lidhur me shpërbërjen e ish-RSFJ-së. Standardet ligjore që mbulojnë çështjet e shtetit pasardhës janë relativisht të reja dhe janë zhvilluar kryesisht kah fundi i viteve të 90-ta dhe fillimi i vitit 2000. Praktika e Gjykatave, përfshirë KEDNJ, pasqyron faktin se të drejtat e ndërlidhura me shtetësinë që janë shkelur (domethënë e drejta e nenit 8 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) renditen si shkelje e të drejtave të njeriut, dhe për këtë qëllim, hyjnë në parimet e sundimit të ligjit.

Lidhur me nenet 31 dhe 32, të dy dispozitat kanë natyrën e fituar të drejtave të mbrojtura nga Kushtetuta në Kapitullin I mbi të drejtën themelore me efekt juridik, kështu që statusi i qytetarit mbrohet edhe me Kushtetutë. Zbatimi praktikohet në zyrën komunale të gjendjes civile, gjithashtu në lidhje me vërtetimin e fakteve ligjore që janë të rëndësishme për konfirmimin e statusit. Krahasimi i Udhëzimit Administrativ 05/2017 për Kriteret që përmbajnë prova mbi Shtetësinë e RFJ-së dhe vendbanimit të përhershëm në territorin e Kosovës më 1 janar 1998, ose Ligjit për Shtetësinë (neni. 31 dhe 32) për mbrojtjen e kësaj të drejte, përshkruan një procedurë për të lëshuar një vendim me shkrim, që do të përmbajë arsyetime dhe prova që janë përdorur si deklaram për zhvillim të procedurës.

Për shkak të respektimit të rreptë të rregullave që janë zhvilluar nga administrata ndërkombëtare në bazë të Rregullores 13/2000 të UNMIK-ut për Regjistrin Qendror Civil e Marsit të vitit 2000, që do të thotë 21 vjet më parë - të cilat janë bartur fjalë për fjalë në dispozitat kalimtare të Ligjit për Shtetësinë (neni 31 dhe 32), do të duhet të rishikohet duke marrë në konsideratë për të përfshirë edhe persona që nuk janë mbuluar nga rregullorja për shkak se në datën e caktuar prerazi kanë qenë me qëndrim jashtë Kosovës, qoftë në republikat e tjera të ish-RSFJ-së, ose në shtetet e tjera që mund të mos kualifikohet me nenin 31 ose 32. Ky mund të jetë rasti i atyre që e kanë origjinën nga Kosova nga paraardhësit e tyre, por kanë lindur jashtë Kosovës (përfshirë territorin e ish-RSFJ-së nga 1 janari 1981 deri më 01.01.1998) dhe mund të mos provojnë lidhjen e tyre me Kosovën me certifikatat e lindjes të paraardhësve dhe mund të jenë në rrezik pa shtetësi (popullata rome), një çështje kjo që është ngritur në shumë raporte të organizatave



ndërkombëtare, duke përfshirë Raportin vjetor të progresit të KE-së për Kosovën, i datës 6 tetor 2020 (faqe 37, 38)<sup>30</sup>.

Për më tepër, është fakt i njohur se emigracioni në Kosovë ekziston për një kohë të gjatë, se ekzistojnë prova të emigrantëve që u larguan nga territori i sotëm qysh në përfundim të Luftës së Parë Botërore, flukset e emigracionit vazhduan dhe fituan në intensitet në vitet 60-ta të shekullit të kaluar, kryesisht për shkaqe të punësimit. Ata që kanë jetuar në Kosovë, duke qenë edhe të lindur atje, por nuk kanë qenë banorë rezidentë në 1 janar 1998, edhe pse duke siguruar mbështetje të konsiderueshme ekonomike për të afërmit të cilët qëndruan në Kosovë, përkatësisht prindërve, duhet të përfshihen në dispozitën që jep shtetësinë me efekt *ex lege*, dhe jo natyralizimi. Në të vërtetë kjo kategori tashmë është e mbuluar nga neni 16, që mbulon "Diasporën e Kosovës".

Në të vërtetë, shtetet janë të lira të hartojnë kushtet për fitimin e shtetësisë së tyre - të cilat duhet të jetë në përputhje me parimet dhe standardet - por mund të mbulojë kategoritë sipas specifikave të vendit, traditave dhe mundësive të tij. Shtetet trajtojnë çështjet e "Diasporës" së tyre, kryesisht si migrim afatgjatë ekonomik i cili mund të shtrihet për të mbuluar më shumë breza, megjithëse dikush duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin, se interesi mbizotërues i shteteve është të sigurojnë shtetësinë për ata që kanë lidhje të mirëfilltë dhe efektive- dhe përmbajtja e kësaj lidhje është çështje e ligjvënësit dhe konsensusit politik i sjellë në Kuvend në një formë të ligjit. Praktika krahasuese në këtë fushë ndryshon, disa vende kanë miratuar ligje të veçanta që merren ekskluzivisht me kushtet e fitimit të shtetësisë së anëtarëve të emigracionit të tyre afatgjatë, disa shtete hezitojnë (vendet kryesisht të së drejtës zakonore që zbatojnë parimin e *jus soli* dhe kufizojnë qasjen në shtetësinë e tyre vetëm te brezi i dytë i lindur jashtë vendit, ndërsa nga ana tjetër, gjithashtu vendet tradicionale të emigracionit - p.sh. Irlanda ofron mundësi të gjerë për të marrë nënshtetësinë e saj. Në disa vende, për shkak të rrethanave specifike të historisë së tyre, u mundësojnë qasje në shtetësinë e tyre edhe për trashëgimtarët e pjesëve të popullsisë të cilët janë zhvendosur me forcë, ose madje edhe të vrarë sistematikisht shekuj më parë (p.sh. Spanja e cila lejoi trashëgimtarët e komunitetit hebre që ishin dëbuar nga territori i Spanjës rreth 500 vjet më parë). Disa shtete mundësojnë rikthimin e shtetësisë në rast se një status i tillë ligjor tashmë kishte ekzistuar, por ishte humbur për shkak të liritimit ose heqjes dorë për shkak të integritetit ekonomik në shtetin e huaj (Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina).

Diaspora në të drejtën krahasuese për shtetësinë nuk është shprehje juridike e harmonizuar ndërkombëtarisht: në kontekstin e kuptimit të përgjithshëm të ditëve të sotme, ajo u prezantua në vitet 90-të të shekullit 20<sup>31</sup>: Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) <sup>32</sup> p.sh. në vitin 2013 prezantoi përkufizimin e Diasporës<sup>33</sup> si: "Emigrantët dhe pasardhësit e tyre që jetojnë jashtë vendit të lindjes ose të prejardhjes, qoftë në baza të përkohshme ose të përhershme, por ende mbajnë lidhje afektive dhe lidhje materiale me vendin e tyre të origjinës".

Ligji për Shtetësinë adreson fitimin e shtetësisë së Diasporës së Kosovës në nenin 16, por e zgjeron mundësinë për tu bërë shtetas i Kosovës vetëm për ata që banojnë ligjërisht jashtë vendit dhe kualifikohen

<sup>30</sup>[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

<sup>31</sup>Safran, W1991: *Diasporas in Modern Societies: Myths of Homeland and Return*, Diaspora 1, p 83-99

<sup>32</sup><https://diaspora.iom.int>

<sup>33</sup><https://www.iom.int/files/live/sites/iom/files/what-We-Do/idm/workshops/IDM-2013-Diaspora-Ministerial-Conference/Background-Paper-2013-Diaspora-Ministerial-Conference-EN.pdf>

për natyralizim me normë të përgjithshme, që mbulon ata që kanë lindur në Kosovë dhe trashëgimtarët e tyre, pa asnjë kufizim kohor të periudhës së lindjes së personit, kështu që në parim mund të përfshihen edhe personat që kanë lindur gjatë kohës kur Perandoria Osmane ushtroi Sovranitetin e saj mbi territorin e sotëm të Republikës së Kosovës. Siç përcaktohet nga standardet e përgjithshme të aplikueshme për shtetësinë, parimi mbizotërues është që të mbulohen personat që kanë një lidhje të mirëfilltë dhe efektive me territorin, një normë e së drejtës zakonore ndërkombëtare, e marrë përsipër nga GjND në rastin e Nottebohm të vitit 1953<sup>34</sup>.

Mangësitë duket të jetë me normën tepër të përgjithshme e cila nuk specifikon lidhjen ekzistuese të mirëfilltë, pra periudhën, gjatë së cilës shumica e personave ende i ruajnë lidhjet me territorin dhe popullsinë, apo madje janë kthyer në Kosovë, duke mos përmbushur kushtet që mbulohen nga neni 31 ose 32. Për më tepër, rregulli nuk bën dallimin e situatave ndërmjet atyre, të cilët ishin banorë të përhershëm në pjesë të tjera të ish-shtetit të përbashkët RSFJ, të cilët nga origjina i përkasin Kosovës, duke ruajtur kulturën, traditat e saj dhe duke i kontribuar zhvillimit ekonomik të shtetit, dhe pas trazirave politike në 1981 janë larguar nga Kosova.

Në nenin ekzistues 16, paragrafi i katërt parashikon një akt nënligjor për t'i përcaktuar kriteret për lidhje të ngushta ekonomike dhe familjare, e ku këto kriteret nuk janë specifikuar mjaftueshëm në aktin nënligjor për procedurat e fitimit të shtetësisë, por janë në nivel të përgjithshëm. Për më tepër, fryma e përgjithshme e Udhëzimit Administrativ, e cila synon të sigurojë përpunim të harmonizuar të të gjitha aplikacioneve dhe të sigurojë kriteret në lidhje me kushtet e përmbushjes për marrjen, humbjen ose regjistrimin e shtetësisë sipas dispozitave të ndryshme të Ligjit për Shtetësinë, përmban barrë të fuqishme të provave, të cilat kryesisht bien mbi aplikuesin, madje edhe nëse bëhet fjalë për dorëzimin e certifikatës së lindjes, martesës – dokumente këto të cilat lëshohen nga institucionet publike, ndërsa zyrtari i gjendjes civile në komunën ku është paraqitur kërkesa ka qasje - dhe kjo vlen edhe në rastet e aplikimit për regjistrimin e shtetësisë së një fëmije të porsalindur. Një praktikë e tillë nuk është e mirë, as në kuptimin e efikasitetit të administratës publike për të ofruar shërbimin për qytetarët, por as si hap drejt thjeshtësimin të procedurave administrative të orientuara në nevojat e përdoruesve, gjithashtu nuk siguron procedura të sigurta dhe me kosto efektive me objektiv për të arritur qëllimin e vendosur nga ligji.

Problemi kryesor në fushën e shtetësisë ndërlidhet por nuk kufizohet vetëm në implementimin e dispozitave ligjore nga ana e nivelit komunal përkatësisht tejkalimin e mandatit dhe autorizimeve nga Zyrtarët e Gjendjes Civile me rastin e regjistrimit të personave në regjistrin e shtetasve. Në këtë kontekst, Zyrtarët e Gjendjes Civile pa pasur autorizime dhe mandat ligjor kryejnë procedura për kategoritë e natyralizimit (kryesisht të pjesëtarëve të Diasporës apo personave të huaj të cilët nuk hyjnë në asnjë kategori juridike për fitimin e shtetësisë) përmes regjistrimit të tyre në Regjistrin Qendror të Shtetasve. Ndër faktorët kryesor të cilët ndikojnë në këtë problematikë, ndërlidhen me dykuptimësitë ligjore përkatësisht interpretimin e gabueshëm të nenit 16 dhe nenit 32 të Ligjit të Shtetësisë. Për më tepër, një kombinim i faktorëve si kapacitetet e kufizuara profesionale në nivel lokal, mungesa e mbikëqyrjes efektive nga ana e nivelit qendror, si dhe mangësitë aktuale në Infrastrukturën e Teknologjisë Informative lidhur me futjen e të dhënave në kuadër të Regjistrin Qendror të Shtetasve, janë disa prej faktorëve shtytës të problemit. Kjo situatë ka prodhuar disa efekte/pasoja siç është cenimi i sigurisë së dokumenteve civile, kërcënimin e sigurisë nacionale dhe publike. Poashtu ka ndikimin edhe në aspektin buxhetor sepse

---

<sup>34</sup><https://www.icj-cij.org/en/case/18/summaries>

besohet se personat të cilët nuk plotësojnë kriteret për të fituar shtetësinë, përfitojnë nga skemat sociale dhe pensionale, punësimit, granteve dhe formave tjera mbështetëse nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Poashtu, kjo situatë ndikon edhe në integritetin e Institucioneve të Kosovës dhe në plotësimin e kriterëve të cilat rrjedhin në kuadër të Procesit të Integritimit Evropian dhe Liberalizimit të mundshëm të vizave me Zonën Schengen.

Sfidë tjetër mbetet edhe një numër i madh i qytetarëve të komunave Preshevë, Medvegjë, Bujanoc, të cilët janë shpërngulur në Kosovë që nga viti 1999, për arsye ekonomike, politike, dhe të sigurisë, dhe për një kohë të gjatë po përballen me çështje të mbetjes pa status dhe qëndrim ligjor, dhe dokumente personale identifikimi, brenda territorit të Republikës së Kosovës. Një pjesë e tyre nuk kanë arritur ta fitojnë të drejtën e shtetësisë në mungesë të dokumentacioneve përkatëse të lëshuar nga autoritetet e shtetit prej nga vijnë. Kjo mënyrë e qëndrimit dhe zhvillimit të jetesës për këta qytetarë është e vështirë në realizimin e një jete normale dhe gëzimin e të drejtave elementare. Në këtë rast për lehtësimin e jetës duhet të parashihen masa lehtësuese që qojnë në fitimin e shtetësisë për këtë kategori të qytetarëve, sidomos që janë duke qëndruar në Republikën e Kosovës për mbi 20 vite. Në këtë drejtim duhet të ndryshohet kuadri ligjor duke ju mundësuar që me masa të posaçme (të lehtësuara) në Ligjin për Shtetësi, ndryshime të tilla të reflektojnë pozitivisht te kjo kategori e qytetarëve në të drejtën e fitimit të shtetësisë.

Realizimi i obligimeve ndërkombëtare në fushën e ripranimit mbetet sfidë për disa kategori, andaj Ligji për Shtetësi për këto kategori duhet të parasheh lehtësira ligjore për regjistrimin e shtetësisë *exleges*, në të kundërtën, disa prej këtyre kategorive rezikojnë të mbesin pa shtetësi, kryesisht lehtësira do të ketë për ato kategori të cilët ndërlidhen me origjinën dhe personave që janë të lindur brenda territorit të Kosovës. Lehtësimi i masave për regjistrimin si shtetas *exleges* për këto kategori do të ndikonte në masë të madhe edhe në integrimin sa më të shpejtë dhe të qëndrueshëm brenda shoqërisë Kosovare, si dhe do të krijonte lehtësira në zbatimin e drejtëpërdrejt të marrëveshjeve ndërkombëtare për ripranim, si dhe Ligjit për Ripranim.

Ligji në fuqi e përmban përkufizimin e personit pashtetësi, i cili është plotësisht në përputhje me Konventën e vitit 1954 mbi Statusin e Personave Pashtetësi, si dhe masat mbrojtëse për parandalimin e pashtetësisë në fëmijëri/moshën madhore, në përputhje me Konventën e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë.

Proceduralisht, që një individ të kërkojë statusin e personit pashtetësi në Kosovë, ai/ajo duhet të inicojë procedurën e nevojshme ligjore për njohjen e këtij statusi. Vetëm me njohjen ligjore të statusit, një person (i huaj me shtetësi të pacaktuar) mund të marrë si në vijim: dokumente personale, të ketë qasje në të drejta të ndryshme, të përfshihet në skemat e mbrojtjes, si dhe të jetë pjesë e shoqërisë si anëtar i barabartë. Për më tepër, përkufizimi i personit pashtetësi është i përshkruar edhe në Ligjin për Azil, Ligjin për të Huajt, Ligjin për Ripranimin, Ligjin për Gjendjen Civile, si dhe në shumë akte të tjera ligjore të ndërlidhura me kornizën ligjore të Kosovës.

Kur bëhet fjalë për procedurën e përcaktimit të statusit të pashtetësisë, hartuesite Ligjit për Shtetësinë nuk kanë paraparë një normë të qartë ligjore që do të rregullonte **procedurat, detyrimet dhe të drejtat e personave me status të njohur të pashtetësisë**. Aktualisht, ekziston një udhëzim administrativ që ofron bazën për shqyrtimin e aplikimeve dhe proceseve të vendimmarrjes. Megjithatë, në përputhje me

standardet ndërkombëtare, rekomandohet përfshirja e një dispozite të veçantë ligjore në Ligjin për Shtetësinë që ofron bazën për zhvillimin e një akti nënligjor specifik për procedurat e përcaktimit të statusit pa shtetësi dhe të drejtat derivuse nga ky status. Prandaj, me qëllim të sigurimit të garancive procedurale, “Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë duhet të formalizohen në ligj”<sup>35</sup>.

Prandaj rekomandohet vendosja e një neni specifik për procedurat e përcaktimit të statusit të pashtetësisë para neneve për natyralizimin e të huajve dhe/ose personave me statusin e refugjatit dhe të personave pashtetësi.

Gjithashtu, normat ligjore për natyralizimin e personave me status tërefugjatit dhe pashtetësisë parashikojnë sigurimin e provave mbi të kaluarën kriminale nga vendi i origjinës/vendi i vendbanimit të fundit, gjë që mund të jetë e pamundur për këto dy kategori që mund të mos jenë në pozicionin për të siguruar dokumentet e kërkuara nga vendi i tyre i origjinës/vendi i vendbanimit të fundit për arsye objektive.

Prandaj, rekomandohet që të zbatohen kushte më të favorshme kur bëhet fjalë për provat mbi të kaluarën kriminale<sup>36</sup> nga vendi i origjinës/vendi i vendbanimit të fundit gjatë aplikimit për natyralizim nga refugjatët dhe personat pashtetësi.

Figura2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nënligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji për Shtetësinë 04-L-215	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetpx?ActID=8873">https://gzk.rks-gov.net/ActDetpx?ActID=8873</a>	Ministria e Punëve të Brendshme	Përcakton mënyrat e fitimit, humbjes dhe rritimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës.
Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2020 për kriteret dhe procedurat e fitimit të shtetësisë së	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31136">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31136</a>	Ministria e Punëve të Brendshme	Përcakton kriteret, procedurat, si dhe mënyrën e fitimit të shtetësisë.

<sup>35</sup>UNHCR Handbook on Protection of Stateless persons, under the 1954 Convention relating to the status of stateless persons, Geneva 2014, part B, section B establishing determination procedures, paragraph 71, at following link: <https://www.unhcr.org/dach/wp-content/uploads/sites/27/2017/04/CH-UNHCR-Handbook-on-Protection-of-Stateless-Persons.pdf>, accessed on 01 November 2021

<sup>36</sup>UN High Commissioner for Refugees (UNHCR), Guidelines on Statelessness No. 4: Ensuring Every Child's Right to Acquire a Nationality through Articles 1-4 of the 1961 Convention on the Reduction of Statelessness, 21 December 2012, HCR/GS/12/04, available at: <https://www.refworld.org/docid/50d460c72.html>, accessed on 02 November 2021

Koncept Dokumenti për Shtetësi

Republikës së Kosovës			
Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 06/2020 për procedurën dhe kriteret e përcaktimit të statusit të personit pa shtetësi, mënyra e fitimit të shtetësisë për personin pa shtetësi dhe personin me status të refugjatit	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31137">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31137</a>	Ministria e Punëve të Brendshme	Përcakton procedurat dhe kriteret për njohjen e statusit të personit pa shtetësi, të drejtat e personit pa shtetësi, si dhe mënyra e fitimit të shtetësisë për personin me status të pa shtetësisë dhe personit me status refugjati në Republikën e Kosovës.
Udhëzimi Administrativ nr. 05/2017 për kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e ish-republikës federale të Jugosllavisë dhe banimin e përhershëm në territorin e Kosovës më 01 janar 1998	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14900">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14900</a>	Ministria e Punëve të Brendshme	Përcakton kriteret që përbëjnë dëshmi të shtetësisë së ish RFJ-së dhe banimit të përhershëm në territorin e Kosovës më 1 janar 1998 sipas nenit 32 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës.
Udhëzimi Administrativ nr. 06/2019 për procedurën e humbjes së shtetësisë së Kosovës me lirim dhe privim	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20689">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20689</a>	Ministria e Punëve të Brendshme	Përcakton procedurat e aplikimit për humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim dhe privim.
Udhëzimi Administrativ (MPB) nr.	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30247">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30247</a>		Themelon dhe përcakton rregullat e punës

03/2020 për themelimin dhe përcaktimin e rregullave të punës së Komisionit të Ankesave për Shtetësi			së Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për fitimin, humbjen dhe revokimin e shtetësisë, si dhe ankesave kundër vendimit për refuzim të njohjes së statusit të pa shtetësisë së Republikës së Kosovës.
Ligji për Gjendjen Civile nr. 04/L-003 i vitit 2011	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2743">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2743</a>	Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia e Regjistrimit Civil	Rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës.

Figura3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

<b>Efektet</b>	Cenimi I sigurisë së dokumenteve.
	Cenimi I sigurisë publike dhe nacionale.
	Ndikimi socio-ekonomik.
	Cenimi i integritetit të procesit dhe besueshmërisë nëinstitucione.
<b>Problemi kryesor</b>	Dispozitat e mangëta të cilat krijojnë zbrazëtira ligjore dhe interpretime të dy kuptueshmërisë nga niveli qendror dhe lokal, sidomos në çështjen e fitimit të shtetësisë.

Koncept Dokumenti për Shtetësi

<b>Shkaqet</b>	Interpretimi i gabueshëminimit 16 dhe 32 të Ligjit të Shtetësisë.
	Kapacitetet e limituar profesionale.
	Boshllëqet në sistemin e gjendjes civile lidhur me futjen e të dhënave në regjistrin e shtetasve.
	Mekanizmi jo efikas i kontrollit nga niveli qendror.

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku apo Efekti (efektet) me të cilin është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion	Cenimi i integritetit të procesit dhe besueshmërisë në Institucione	Divizioni për Shtetësi si organ kompetent përgjegjës për përpunimin dhe procesin e vendimmarrjes për kërkesat për natyralizime. Në anën tjetër, Zyrat e Gjendjes Civile si rezultat i dykuptimisë së ligjore respektivisht interpretimit të gabueshëm të dispozitave ligjore dhe përmes futjes së të dhënave në regjistrin qendror të shtetasve, kryejnë procedura të natyralizimit edhe në rastet kur personat nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara me Ligj. Kjo situatë ndikon në integritetin dhe besueshmërinë e procesit rrjedhimisht edhe në vet Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion si organ kompetent, përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fushën e shtetësisë.
Agjencia e Regjistrimit Civil	Mekanizmi jo efikas i kontrollit nga niveli qendror	Agjencia e Regjistrimit Civil përkatësisht Inspektorati ka për mandat të mbikëqyr zbatimin e legjislacionit në fushën e gjendjes civile dhe në këtë kontekst ka ndikim edhe në çështjet të cilat ndërlidhen me shtetësinë. Sidoqoftë, në mungesë të mbikëqyrjes proaktive dhe kontrollit efikas nga ana e ARC-së, dhe boshllëqeve aktuale në sistemin e teknologjisë informative, sa i përket futjes së të dhënave në regjistrin qendror të shtetasve ka rezultuar me raste të tejkalimit të autorizimeve dhe mandatit nga ana e Zyrate Komonale të Gjendjes Civile të cilat reflektohen edhe në fushën e shtetësisë. Plotësimi ndryshimi i Ligjit për Shtetësi dhe atij për Gjendjen Civile konsiderohen si mundësi e mirë për të fuqizuar mbikëqyrjen, kontrollin dhe llogaridhënien nga ana e nivelit

		qendror në raport me Zyrat Komunale të Gjendjes Civile.
Zyrat Komunale të Gjendjes Civile	Interpretimi i gabueshëm i Nenit 16 dhe 32 të Ligjit të Shtetësisë	Zyrat Komunale të Gjendjes Civile kanë përgjegjësi në fushën e shtetësisë sipas dispozitave ligjore të përcaktuara me Ligjin e Shtetësisë dhe Ligjin e Gjendjes Civile. Është e evidente se ka mungesë të theksuar të kapaciteteve profesionale në raport me çështjet të cilat lidhen me shtetësinë dhe kjo dëshmohet në rastet e interpretimit të gabueshëm të nenëve 16 dhe 32 të Ligjit të Shtetësisë, përmes së cilave kryhen procedura të natyralizimit. Në disa raste të natyralizimit të cilat janë më shumë përjashtim se sa rregull, kemi pasur edhe tejkalim të përgjegjësive dhe keqpërdorim të detyrës, të cilat më pastaj janë anuluar nga organi kompetent (DSHAM) ose janë proceduar për ndjekje penale nga ana e autoriteteve të zbatimit të ligjit. Për këtë qëllim, në kuadër të këtij Koncept Dokumenti është rekomanduar të shqyrtohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për Shtetësinë për të eliminuar çfarëdodokuptimësi ligjore si dhe ngritjen e kapaciteteve për të zhvilluar bazën e njohurive për çështjet e shtetësisë.

## Kapitulli 2: Objektivat

Qëllimi kryesor përkufizohet në çështjen e lehtësimit të procedurave për kategori të veçanta juridike me qëllim të ndikimit pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të vendit dhe parandalimit të pashtetësisë. Ky qëllim është i reflektuar edhe në kuadër të dokumenteve strategjike të Qeverisë, përkatësisht në Strategjinë e Migrimit 2021-2025, si dhe pjesërisht në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, përkatsisht shtyllat të cilat i referohen Rritjes së Qëndrueshme Ekonomike, Kapitalit Njerëzor dhe Shoqërisë së Barabartë.

Ndërsa sa i përket objektivit Strategjik, më këtë Koncept Dokument synohet harmonizimi i mëtutjeshëm i legjisllacionit dhe avancimi i kapaciteteve institucionale në fushën e kontrollit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të legjisllacionit në fushën e shtetësisë.

Me qëllim të arritjes së objektivit strategjik janë paraparë objektiva specifike sipas modelit S.M.A.R.T të cilat janë në kohezion me vet qëllimin e politikës dhe rrjedhin si rezultat i analizës së situatës përkatësisht defekteve të identifikuara në fushën e shtetësisë. Në këtë kontekst synohet të adresohen çështjet si në vijim:

- 1) Fuqizimit i kontrollit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjisllacionit në fushën e shtetësisë;
- 2) Ngritja e kapaciteteve për të zhvilluar bazën e njohurive profesionale në zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shtetësisë;
- 3) Avancimi i sistemit qendror të shtetasve dhe zhvillimin e procedurave bazuar në Teknologji Informativë.



Këto objektiva nuk kanë ekzistuar më parë në kuadër të dokumenteve planifikuese strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Poashtu, përtej Strategjisë së Migrimit 2021-2025, dokument ky që ka paraparë masa të cilat synojnë harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit, lehtësimit të procedurave për kategori të veçanta dhe avancimin e kapaciteteve institucionale përgjegjëse në fushën e shtetësisë, në përcaktimin e objektivave strategjike dhe specifike është marrë në konsideratë edhe debati në diskursin publik lidhur me çështjen e shtetësisë sidomos në kontekst të proceseve zgjedhore në vend përkatësisht të drejtës për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur.

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

<b>Qëllimi I politikës:</b>	<b>Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)</b>
<i>Qëllimi:</i> Lehtësimi i procedurave për kategori të veçanta juridike dhe parandalimit të pashtetësisë.	Strategjia e Migrimit 2021-2025
<i>Objektivi strategjik:</i> Harmonizimi i legjislacionit dhe avancimi i kapaciteteve institucionale në fushën e kontrollit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e shtetësisë.	Sipas këtij Koncept Dokumenti
<i>Objektivat specifike:</i> 1) Fuqizimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fushën e shtetësisë; 2) Ngritja e kapaciteteve për të zhvilluar bazën e njohurive profesionale në zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shtetësisë; 3). Avancimi i sistemit qendror të shtetasve dhe zhvillimin e procedurave bazuar në Teknologji Informative.	Sipas këtij Koncept Dokumenti

## Kapitulli 3: Opsionet

Në zhvillimin dhe analizimin e opsioneve, janë marrë parasysh të gjeturat kryesore nga procesi i analizës së situatës përkthashtdiagnotifikimit të problemit duke përfshirë shkaqet dhe efektet kryesore të tij. Në këtë drejtim në bazë të opsioneve të paraqitura, vendimmarrja lidhur me opsionin më të arsyeshëm për arritjen e objektivave strategjike dhe specifike në fushën e shtetësisë do të jetë më e lehtë për shkak se, secili opsion është elaboruar dhe janë ofruar sqarime lidhur me mangësitë dhe përparësitë e secilit prej tyre.

### Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Vazhdimi i gjendjes ekzistuese duke mos ndërmarrë asnjë masë ligjore, strategjike apo institucionale do të këtë ndikim negativ në të gjitha sferat të cilat preken nga fusha e shtetësisë. Në këtë drejtim, nëse vazhdohet me këtë qasje, efektet e problemit do të përshkallëzohen në atë masë sa do të cenonjë sigurinë dhe kredibilitetin e dokumenteve civile, rrezikimin e statusit të kategorive të cënueshme, kërcënimin esigurisë publike dhe nacionale, cenimin e integritetit të procesve zgjedhore, tejkalimin e autorizimeve dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare, integritetin e Institucioneve të Republikës së Kosovës, pastaj do të

këtëimpakt financiar sidomos në rastet kur personat fitojnë shtetësinë pa plotësuar kriteret ligjore dhe rrjedhimisht gëzojnëbenefitet nga skemat pensionale, sociale, apo skemat tjera përfituese nga buxheti i vendit etj. Në këtë kontekst,opsioni i ruajtjes së ‘status quo-s’ nuk është njëopsion i cili gëzon mbështetjen e akterëve institucional të përfshirë në fushën e shtetësisë.

### Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore

Është vlerësim i përbashkët i akterëve të përfshirë në fushën e shtetësisë se Ligji për Shtetësinë dhe pesë Udhëzimet Administrative për zbatimin e tij, në kuptimin e masave mbrojtëse të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, gjithashtu në kuptim të faktit të epërsisë së të drejtës dhe traktateve ndërkombëtare kundrejt të drejtës vendore, përgjithësisht janë në përputhje me standardet e zbatueshme ndërkombëtare në fushën e shtetësisë dhe praktikën ekzistuese shtetërore. Sidoqoftë, Ligji aktual ka disa mangësi të cilat janëelaboruar në seksionin e analizës së problemit, duke përfshirë edhe defektet e identifikuar në zbatimin e dispozitave ligjore sidomos në nivelin lokal, si dhe mungesën e kontrollit dhe mbikëqyrjes efektive nga ana e nivelit qendror.

Në kuadër të këtij opsioni janë propozuar disa masa të cilat synojnë adresimin e defekteve të identifikuar përmes fuqizimit të zbatimit të legjislacionit ekzistues. Në këtë drejtim rekomandohet të zhvillohet një program për ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët të cilët merren me zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shtetësisë, rishikimin funksional të institucioneve përgjegjëse duke i bartur përgjegjësi autoritetit kompetent (DSHAM) në kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit tëligjit në nivel lokal, ofrimin e lehtësirave administrative për regjistrimin e lindjeve, organizimin e fushatave senzibilizuese për realizimin e të drejtave për kategori të cënueshme etj. Ndërmarrja e këtyre masave padyshim se do të përmirësonte nivelin e zbatimit të legjislacionit në fushën e shtetësisë, duke ndikuar kështu në ngritjen e kualitetit të shërbimeve, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike.

### Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë i rekomanduar

Me qëllim të adresimit të çështjes së Dispozitave të mangëta të cilat po krijojnë zbrazëtira ligjore dhe intepertime duale në çështjen e fitimit të shtetësisë si dhe me qëllim që të arrihet pajtueshmëri e plotë e Ligjit për Shtetësinë dhe Udhëzimeve Administrative, me praktikën dhe standardet që janë zhvilluar gjatë 12 viteve të fundit, me fokus në përkufizimin e saktë të Diasporës në kontekst të fushës së shtetësisë, evitimin e pashtetësisë duke përfshirë të drejtat e pakicave, dhe rregullat procedurale që përpiqen të thjeshtësojnë procedurat burokratike, si dhe për të siguruar standarde të larta profesionale në zbatimin e detyrave të autoritetit kompetent (DSHAM) lidhur me çështjet e shtetësisë, rekomandohet hartimi i Ligjit të ri për Shtetësinë duke intervenuar në dispozitat e ligjit aktual të cilat prekin çështjet e mësipërme. Bazuar në problematikat e elaboruara në këtë koncept dokument dhe mangesitë ligjore që janë hasur në zbatim, rekomandimi do të jetë Ligji i Ri për Shtetësinë, i cili mbështetet nga Grupi Punues dhe bazohet në tërësi në analizën e situatës dhe të gjeturat nga diagnostifikimi i problemit kryesor, faktorëve të cilët e nxisin dhe efekteve që shkakton.

Përmes ligji të ri synohet të zgjidhen problematikat si më poshtë:

- Fuqizimi i mekanizmave në zbatim të dispozitave ligjore nga ana e nivelit qendror për nivelin komunal.
- Fuqizimi i Infrastrukturës së Teknologjisë Informative për të dhënat e regjistrimit Qendror të Shtetasve.

- Për qytetarët e komunave Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, do të parashihen masa afirmative dhe pozitive për veprim për këtë kategori për të fituar të drejtën e shtetësisë.
- Të gjithë qytetarët nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të cilët kanë qëndruar në RKS së paku 5 vite nga data 12.06.1999 deri me datë 31.12.2021, do të kenë të drejtën e fitimit të Shtetësisë bazuar në rregullimin e kornizës ligjore me këtë Koncept Dokument, ndërsa sa i përket kriterëve procedurale do të rregullohet me akte nënligjore.
- Të krijohen lehtësira ligjore për regjistrimin e shtetësisë për personat të cilët kthehen në bazë të procesit të ripranimit, e të cilët persona janë me qëndrim të parregullt në shtetet kthyesë dhe të cilët kemi obligim ndërkombëtar për t'i ripranuar.
- Vendosja e një neni specifik për procedurat e përcaktimit të statusit të pashtetësisë para neneve për natyralizimin e të huajve dhe/ose personave me statusin e refugjatit dhe të personave pashtetësi.
- Zbatimi i kushteve më të buta kur bëhet fjalë për provat mbi të kaluarën kriminale<sup>37</sup> nga vendi i origjinës/vendi i vendbanimit të fundit gjatë aplikimit për natyralizim nga refugjatët dhe personat pashtetësi.

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Ndikimet e pritshme janë identifikuar dhe elaboruar në kuadër të këtij Kapitulli, duke u bazuar në opsionin i cili ka gjetur mbështetje nga grupi punues, përkatësisht opsioni i plotësim-ndryshimit të Ligjit për Shtetësinë.

Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Mundësia e fitimit të shtetësisë për pjesëtarët e Diasporës së Kosovës me kushte transparente, siç parashikohet në dispozitën e ndryshuar të nenit 16 të Ligjit për Shtetësinë, do të kishte ndikim për shkak të potencialit për investime nga pjesëtarët e Diasporës së Kosovës në ekonominë e Kosovës.  Zgjerimi i mundësisë për të fituar shtetësinë e Kosovës edhe për ata persona që kishin një lidhje të përshtatshme me Kosovën me lindje por që nuk kishin ruajtur vendqëndrimin e rregullt në Kosovë, ofron mundësinë e fitimit të shtetësisë për kategorinë e të rinjve, të cilët me fitimin e shtetësisë pas vendosjes së vendqëndrimit në Kosovë mund të kontribuojnë në ekonominë e Kosovës me aftësitë, ekspertizën dhe potencialin e tyre.
Ndikimet shoqërore	Ndikimi i integritit ekonomik të personave të natyralizuar duke krijuar vende të reja pune mund të ketë ndikim shoqëror përkatësisht të ndikoj në uljen e shkallës së papunësisë së të rinjve, të cilët përndryshe do të përcaktoheshin për emigrim—të ligjshëm ose të paligjshëm—jashtë vendit.
Ndikimet mjedisore	Shtetësia si status ligjor nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në mjedis. Por, përpunimi i lëndëve përkatësisht aplikimet për natyralizim me dokumente mbështetëse, humbja e aplikimeve të shtetësisë, aplikimet për regjistrimin e

<sup>37</sup>UN High Commissioner for Refugees (UNHCR), Guidelines on Statelessness No. 4: Ensuring Every Child's Right to Acquire a Nationality through Articles 1-4 of the 1961 Convention on the Reduction of Statelessness, 21 December 2012, HCR/GS/12/04, available at: <https://www.refworld.org/docid/50d460c72.html>, accessed on 02 November 2021

	shtetësisë dhe nxjerrja e certifikatave të shtetësisë kanë ndikim në mjedis për nga konsumi i letrës. Përpunimi i aplikimeve bazohet në sistemin alfanumerik i cili bazohet në letër.
Ndikimet në të drejtat themelore	Ndikim te lehtësimit i procedurave të riintegrit të grupeve të cenueshme, të cilët nuk mund të natyralizoheshin për shkak të mosregjistrimit të vendqëndrimit në Kosovë, megjithëse në të vërtetë kishin qenë me vendqëndrim në territorin e Kosovës.  Ndikim tek të huajt në rastet kur revokohet ose humbet për shkak të arsyeve të sigurisë, si dhe për shkak të mospërmbushjes së kushteve për natyralizim. Masat mbrojtëse procedurale dhe respektimi i tyre luajnë rol të rëndësishëm edhe në fushën e të drejtave themelore (p.sh. bashkimi familjar, të drejtat e fëmijës etj).
Ndikimi gjinor	Plotësim-ndryshimi i legjislacionit në fushën e shtetësisë, si dhe masat/ndryshimet e propozuara në nivel institucional dhe organizativ, nuk pritet të kenë ndikim gjinor.
Ndikimet e barazisë sociale	Plotësim-ndryshimi i legjislacionit në fushën e shtetësisë, si dhe masat/ndryshimet e propozuara në nivel institucional dhe organizativ, nuk pritet të kenë ndikim në çështjet e barazisë sociale.
Ndikimet tek të rinjtë	Plotësim-ndryshimi i legjislacionit në fushën e shtetësisë, si dhe masat/ndryshimet e propozuara në nivel institucional dhe organizativ, nuk pritet të kenë ndikim të theksuar tek të rinjtë.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Plotësim-ndryshimi i legjislacionit në fushën e shtetësisë, si dhe masat/ndryshimet e propozuara në nivel institucional dhe organizativ, nuk pritet të ketë ndikim në ngarkesën administrative.
Ndikimi i NMV-ve	Plotësim-ndryshimi i legjislacionit në fushën e shtetësisë, si dhe masat/ndryshimet e propozuara në nivel institucional dhe organizativ, nuk pritet të ketë ndikim tek NVM-të.

Një elaborim më i detajuar i ndikimeve të mundshme përkitazi me opsionin e propozuar në këtë Koncept Dokument është paraqitur në vijim:

### 1. Identifikimi i ndikimeve ekonomike:

Shtetësia është një kategori specifike ligjore e statusit e cila lidhet ngushtë me natyrën e mirëfilltë të vet Shtetit. Si e tillë, ajo gjithashtu ka ndikim ekonomik mbi statusin e përgjithshëm të Shtetit, veçanërisht duke marrë parasysh integrimin e tij në bashkësinë ndërkombëtare, ose anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

Për më tepër, monitorimi i trendeve demografike të shtetësisë në planin afatgjatë është një nga mjetet ekonomike themelore të punonjësve statistikorë në fushën e masave makroekonomike kombëtare. Kjo mund të bëhet vetëm nëse ekzistojnë përkufizime të qarta sipas Ligjit për Shtetësinë dhe mjete të zhvilluara për mbledhjen dhe analizimin e trendeve për qëllimet e parashikimeve ekonomike.

Ndikimi ekonomik i ndryshimeve të propozuara të ligjit dhe akteve nënligjore për shtetësinë, dhe i masave të politikës për shtetin si në Republikën e Kosovës, të cilat u shfaqën në rrethana specifike, ku pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 2008, akoma jo të gjitha shtetet e bashkësisë ndërkombëtare kanë njohur

pavarësinë e saj, prandaj ai duhet të matet kundrejt harmonizimit të legjislacionit të përgjithshëm të shtetësisë me standardet e së drejtës ndërkombëtare zakonore në këtë fushë.

Mungesa e anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare ndikon gjithashtu në pamundësinë e aplikuesve për të kundërshtuar vendimet mbi shtetësinë (negative) të nxjerra nga autoritetet kompetente të Kosovës në gjykatat ndërkombëtare (p.sh. GJEDNJ), ose në GJND. Rrjedhimisht, kjo ka ndikim në vetë themelet e Shtetit, besimin në institucionet e tij dhe mundësinë e testimi të ligjshmërisë nën kompetencën e gjykatës ndërkombëtare. Mungesa e një cilësie të tillë mund të pengojë vendimet për investimet e huaja në ekonominë e Kosovës.

Nuk duhet të shpërfillet, që një nga lëndët më të njohura nën kompetencën e gjykatave ndërkombëtare që kishte të bënte me të drejtën e Shtetit për të ofruar mbrojtjen e tij diplomatike është lënda Nottebohm<sup>38</sup>, që përcaktoi gjithashtu konceptin e shtetësisë 'Shtetësia është një lidhje juridike që ka për bazë të vetën një fakt shoqëror të lidhjes, një lidhje të mirëfilltë të ekzistencës, interesit dhe ndjenjave, së bashku me ekzistencën e të drejtave dhe detyrave të ndërsjella.' Së këndejmi, shtetësia përcaktohet për nga lidhjet shoqërore të personit me vendin e tij, dhe kur vendoset, krijon të drejta dhe detyra nga ana e shtetit, si dhe nga ana e shtetasit.

Poashtu shtetësia ka ndikim në një nga prioritetet kryesore të Kosovës në bashkëpunimin ndërkombëtar, që është i lidhur ngushtë me lirinë e lëvizjes së shtetasve të Republikës së Kosovës në BE. Kosova vazhdon të mbetet vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor qytetarët e së cilës ende nuk mund të lëvizin pa viza në Zonën Schengen përkundër faktit se Komisioni Evropian ka konstatuar përmbushjen e të gjitha kriterëve dhe ka rekomanduar heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës mirëpo një rekomandim i tillë ende nuk ka gjetur mbështetjen e plotë në Këshillin e BE-së për shkak të skepticizmit të shfaqur nga disa shtete anëtare.

Popullsia e përhershme e një territori specifik, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare zakonore<sup>39</sup>, duke marrë parasysh pavarësinë e proklamuar pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, është një nga kualifikimet për Shtetin si subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Ligjërisht, popullsia e përhershme e Shtetit pas pavarësisë dhe njohjes ndërkombëtare të një akti të tillë, shndërrohet në status relevant juridik të shtetësisë. Së këndejmi, kjo nuk nënkupton vetëm dimensionin e përcaktuar nga e drejta e brendshme, por edhe marrëdhëniet ndërkombëtare në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, dhe për këtë qëllim, edhe rolin e Shtetit për mbrojtjen diplomatike të qytetarëve.

Kapacitetet e Shtetit për të ofruar statusin e duhur si qytetar për të gjithë personat që kualifikohen sipas sistemit të tij ligjor, është një nga elementet e sundimit të së drejtës. Transparenca e procedurave për të gjithë, përpunimi i shpejtë i bazuar në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit janë ndër parakushtet që duhet të plotësohen si kushte themelore mbi të cilat bazohet parimi i sundimit të së drejtës. Krahasuar me BE<sup>40</sup>, "respektimi i sundimit të së drejtës është thelbësor për qytetarët dhe bizneset, që të ketë besim në institucionet publike". Liberalizimi i vizave me BE-në i cili gjithashtu bazohet në parimet e sundimit të së drejtës, për qytetarët e Kosovësdo t'i japë shtytje integritit në BE dhe së këndejmi luan rol të rëndësishëm edhe në sektorin e ekonomisë.

<sup>38</sup> <https://www.icj-cij.org/public/files/case-related/18/2676.pdf>

<sup>39</sup> <https://www.jus.uio.no/english/services/library/treaties/01/1-02/rights-duties-states.xml>

<sup>40</sup> [https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/communication\\_2020\\_rule\\_of\\_law\\_report\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/communication_2020_rule_of_law_report_en.pdf)

Ndikimi ekonomik i zgjidhjeve të propozuara siç përcaktohen në objektivat nën këtë koncept dokument që do të zbatoheshin në kuadër të plotësim-ndryshimet e ligjit për shtetësinë dhe akteve të reja nënligjore:

1) regjistrimi i shtetasve “ex officio” (sipas detyrës zyrtare) dhe jo përjashtimisht me iniciativë të individit, do të ofronte sistem më efikas dhe transparent për regjistrimin e shtetasve nën kontrollin e autoritetit kompetent (MPB/DSHAM) për çështjet e shtetësisë;

2) Mundësia e fitimit të shtetësisë për pjesëtarët e Diasporës së Kosovës me kushte transparente, siç parashikohet në dispozitën e ndryshuar të nenit 16 të Ligjit për Shtetësinë dhe akteve nënligjore që do të përcaktonin kriteret për lidhjet shoqërore, ekonomike dhe familjare me Kosovën, do të ngriste besimin në institucione. Ekziston një potencial i fortë për investime nga pjesëtarët e Diasporës së Kosovës në ekonominë e Kosovës, nëse fitimi i shtetësisë do të lehtësohet me kushte objektive dhe transparente. Aq më tepër, nëse kushtet do të bazohen në kritere strikte të lidhjeve më të afërta efektive dhe të mirëfillta me Kosovën. Investimet e Diasporës në ekonominë e Kosovës mund t’i japin shtytje punësimit më të madh të të rinjve, duke parandaluar emigrimin e tyre jashtë vendit dhe në vend të kësaj të kontribuojnë në rritjen e ekonomisë së vendit.

3) Zgjerimi i mundësisë për të fituar shtetësinë e Kosovës edhe për ata persona që kishin një lidhje të përshtatshme me Kosovën me lindje ndërmjet 1.1.1981 dhe 1.1.1998, por që nuk kishin ruajtur vendqëndrimin e rregullt në Kosovë në datën e përcaktuar 1.1.1998, ose kurrë nuk kishin pasur vendqëndrim të rregullt (siç parashikohet në nenin 32 dhe nenin 31 të Ligjit për Shtetësinë), nëse përmbushin kushtet e përgjithshme të natyralizimit siç përcaktohen në nenet 9 dhe 10 (1,2,3,4) ofron mundësinë e fitimit të shtetësisë për kategorinë e të rinjve, të cilët me fitimin e shtetësisë pas vendosjes së vendqëndrimit në Kosovë mund të kontribuojnë në ekonominë e Kosovës me aftësitë, ekspertizën dhe potencialin e tyre.

**Rekomandimi për integrimin e çështjes së shtetësisë në kuadër të politikave strategjike në fushën e Migrimit,** do të ketë ndikim ekonomik me masa adekuate dhe me kohë lidhur me parashikimin e ndryshimeve demografike, bazuar në monitorimin e trendeve dhe niveleve të fitimit të shtetësisë me lindje, me regjistrimin e lindjeve të shtetasve nga jashtë, si dhe me natyralizimet si dhe lirin dhe heqjen dorë nga shtetësia për shkak të integritit shoqëror-ekonomik jashtë vendit. “Ikja e trurit” e shtetasve më të rinj, me kualifikime të larta, të cilët emigrojnë për arsye ekonomike është humbje e kapitalit njerëzor përgjithmonë, nëse nuk parashikohen masa progresive për të frenuar trendin dhe ofrimin e mundësisë për punësimin e tyre në vend.

**Bashkëpunimi i propozuar i ekspertëve të DSHAM në përgatitjen e reformës së Administratës Publike,** do të çonte në sinergji dhe efikasitet më të mirë të proceseve të punës, do të zvogëlonte barrën administrative dhe do të mund të kontribuonte në futjen e sistemit të menaxhimit të lëndëve. Në këtë mënyrë proceset e përgjithshme nën kompetencën e Divizionit të Shtetësisë/DSHAM/Ministria e Punëve të Brendshme, duke përfshirë lëndët e mundshme nëse propozimi i këtij dokumenti do të zgjeronte fitimin e shtetësisë për kategori të reja të aplikuesve, do të mund të standardizohen dhe ekonomizohen, pra ndikimi ekonomik do të ishte një administratë më pak e kushtueshme dhe efikasiteti dhe efektiviteti më i lartë i shërbimeve të ofruara.

**Ndërtimi i kapaciteteve të trajnimit rreth njohurive të përhershme** për personelin që merret me çështjet e shtetësisë, jo vetëm në DSHAM, do të kishte ndikim në njohuritë më të mira profesionale, të

strukturuara dhe të organizuara nga një plan-program mësimor i detajuar dhe futja në përdorim e provimeve profesionale. Një qasje e tillë do të kishte ndikim në cilësinë më të lartë të shërbimeve të kryera, më pak lëndë “të humbura” në shqyrtimet gjyqësore dhe besimin më të lartë të publikut në institucione. Kostot e zhvillimit të trajnimit të investuar në staf do të ekonomizohen nga shkalla më e lartë e efikasitetit profesional.

Ndryshimi i masave organizative, duke fuqizuar DSHAM/Divizionin për Shtetësi duke transferuar kontrollin dhe mbikëqyrjen e përpunimit të të gjitha kërkesave në fushën e shtetësisë të paraqitura në zyrat komunale nga Agjencia e Regjistrimit Civil, do të kontribuonte në vartësinë e duhur ligjore ndaj njësisë organizative të Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila zbaton Ligjin për Shtetësinë. Me këto masa do të kontrollohej llogaridhënia dhe përgjegjësia për lëshimet eventuale dhe veprimet e mundshme të gabuara, apo edhe keqpërdorimin e mandatit ligjor sipas Ligjit për Shtetësinë në nivelin lokal. Ndikimi ekonomik masës së tillë do të matej kundrejt numrit më të vogël të gabimeve, dhe kontrollit kundër keqpërdorimeve, duke përfshirë korrupsionin e mundshëm në nivelin komunal.

## **2. Identifikimi i ndikimeve shoqërore**

Përmirësimi i legalizimit të shtetësisë, shoqëruar nga reformat e politikave dhe ato organizative, duke prezantuar gjithashtu trajnimin profesional shumë-disiplinor në fushën e shtetësisë, do të ketë gjithashtu ndikim pozitiv në mënyrë që të përcaktojë për nga aspekti sasior dhe cilësor ndikimet e shtetësisë edhe në sferën shoqërore.

Aktualisht, një metodologji e tillë nuk është identifikuar, por ajo do të duhej të zhvillohet dhe të integrohet në Politikën Strategjike në fushën e Migrimit. Ndikimi i integritit ekonomik të personave të natyralizuar duke krijuar vende të reja pune mund të ketë ndikim shoqëror përkatësisht të ndikoj në uljen e shkallës së papunësisë së të rinjve, të cilët përndryshe do të përcaktoheshin për emigrim—të ligjshëm ose të paligjshëm—jashtë vendit, ose uljen e ikjes së qytetarëve për qëllime të punës fizike jashtë vendit dhe si pasojë humbjen e investimeve në arsim me diplomë universiteti.

## **3. Identifikimi i ndikimeve mjedisore**

Shtetësia si status ligjor nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në mjedis. Por, përpunimi i lëndëve nën kompetencën e Divizionit të Shtetësisë dhe zyrave komunale të gjendjes civile - aplikimet për natyralizim me dokumente mbështetëse, humbja e aplikimeve të shtetësisë, aplikimet për regjistrimin e shtetësisë dhe nxjerrja e certifikatave të shtetësisë kanë ndikim në mjedis për nga konsumi i letrës. Përpunimi i aplikimeve bazohet në sistemin alfanumerik i cili bazohet në letër.

Së dyti, pjesëmarrja në trafik, udhëtimi i popullsisë nga vendqëndrimi deri te autoriteti komunal apo edhe qendror përgjegjës për shtetësinë, ka korrelacion për shkak se përdoret qoftë transporti publik ose ai privat. Në të dyja rastet, trafiku ka ndikim në mjedis, i cili efekt mund të mos matet pa një analizë koncize (sa aplikues aplikojnë për dokumente të shtetësisë dhe aplikimet e ndërlydhura me të brenda vitit).

Ky ndikim do të mbetet i pandryshuar derisa të funksionalizohet sistemi i menaxhimit të lëndëve sipas proceseve të përpunimit, si dhe e-qeverisja të zëvendësojë qasjen aktuale duke futur në përdorim gjithashtu sistemin qendror të e-popullsisë. Sistemi i tillë operon në të vërtetë në mbarë Shtetin dhe mundëson qasjen në bazat e të dhënave nga të gjitha pikat hyrëse në Shtet. Një plotësim-ndryshim i Ligjit për Procedurën Administrative i cili do të detyrojë të gjitha autoritetet kompetente të Shtetit të cilët vendosin në procedurë administrative për të drejtat, interesin ligjor ose detyrimet, për të përdorur të

dhëna të obligueshme për shtetësinë nga baza zyrtare e të dhënave, natyrisht nën kushte të respektimit të rreptë të mbrojtjes së të dhënave, do të ndryshonte në mënyrë drastike rutinën dhe do të kishte gjithashtu ndikim pozitiv në uljen e ndikimit në mjedis për shkak të racionalizimit të procedurave.

#### **4. Ndikimet në të drejtat themelore**

Siç është theksuar tashmë në pjesën për ndikimin ekonomik, ndryshimi i legjislacionit për shtetësinë, ndërhyrja e politikave mbi shtetësinë në kuadër të politikave strategjike në fushën e migrimit, trajnimi i detyrueshëm në punë i personelit që mbulon gjithashtu aspektet e të drejtave themelore dhe ndryshimi i strukturës organizative (transferimi i kompetencave të kontrollit dhe mbikëqyrjes për shtetësinë nga ARC te Departamenti i Shtetësisë, Azilit dhe Migracionit) kanë një ndikim në të drejtat themelore. Harmonizimi i ligjit me standardet e aplikuara të suksesionit për shtetësinë - qoftë të zhvilluara nga e drejta ndërkombëtare e traktateve ose e drejta ndërkombëtare zakonore pas vitit 2000, (neni i ri i propozuar për natyralizimin e personave të lindur në Kosovë ndërmjet 1.1.1981 dhe 1.1.1998 - të cilët nuk kanë pasur vendqëndrim të rregullt më 1.1.1998), si dhe propozimi për regjistrimin e shtetësisë sipas detyrës zyrtare (neni 27) dhe jo vetëm me aplikim, do të përafroj legjislacionin në përputhje me zhvillimet e fundit. Pjesërisht, kjo do të lehtësojë disa procedura të riintegrit të grupeve të cënueshme, gjegjësisht qytetarëve të komunitetit Romë dhe Ashkali të cilët nuk mund të natyralizoheshin për shkak të mosregjistrimit të vendqëndrimit në Kosovë, megjithëse në të vërtetë kishin qenë me vendqëndrim në territorin e Kosovës. Masat për futjen e trajnimit të detyrueshëm, të zhvilluara si plan-program mësimor për të gjithë punonjësit e administratës publike me kompetenca që lidhen me shtetësinë, do të kenë ndikim të drejtpërdrejt në të drejtat themelore dhe mbrojtjen e tyre - moduli i trajnimit me provim, duke përfshirë edhe të drejtat themelore të njeriut, do të kontribuojë në rritjen e shkallës së profesionalizimit dhe do të kontribuojë në forcimin e sundimit të së drejtës.

Statusi i shtetësisë (kombësisë) nuk është pjesë e Acquis të BE, por bëhet relevant për Acquis, pjesa që u referohet të huajve, në veçanti në rast të largimit me forcë nga territori i Shtetit kur shtetësia revokohet ose humbet për shkak të arsyeve të sigurisë, si dhe për shkak të mospërmbyshjes së kushteve për natyralizim. Masat mbrojtëse procedurale dhe respektimi i tyre luajnë rol të rëndësishëm edhe në fushën e të drejtave themelore (p.sh. bashkimi familjar, të drejtat e fëmijës). Dhe në këtë drejtim, kapaciteti trajnues me ofrimin e njohurive të duhura mbi të drejtat themelore ka ndikim të rëndësishëm.

#### **5. Vlerësimi i ndikimit gjinor**

Përmirësimi i legjislacionit, siç është propozuar, së bashku me pjesën e shtetësisë në kuadër të Politikave Strategjike në fushën e Migrimit dhe masat/ndryshimet në nivel institucional dhe organizativ, nuk janë identifikuar të kenë ndikim gjinor. Politika e punësimit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ashtu si edhe në nivelin komunal, nuk ofron dëshmi që ka diskriminim në lidhje me punësimin e grave në sektorin e shtetësisë. Poashtu nuk është identifikuar praktika e autoritetit kompetent në lidhje me praktikën diskriminuese gjinore lidhur me aplikimet e paraqitura në fushën e shtetësisë.

#### **6. Vlerësimi i ndikimit tek të rinjtë**

Përmirësimi i legjislacionit, siç është propozuar së bashku me pjesën e shtetësisë në kuadër të Politikave Strategjike në fushën e Migrimit dhe masat/ndryshimet në nivel institucional dhe organizativ, nuk pritet të kenë ndikim të përgjithshëm te të rinjtë. Pjesërisht, nëse përfshihen në fushatën e promovimit për mundësitë e reja sipas Ligjit për Shtetësinë, ata mund të kontribuojnë në mënyrë aktive që publiku i gjerë



të kuptojë më mirë grupet e synuara që do të përfitojnë nga ndryshimet. Nga ana tjetër, një pjesë e të rinjve që mund të punësohen në sektorin e biznesit ose shërbimet e krijuara nga qytetarët e sapo natyralizuar që investuan në ekonominë lokale, mund të përfitojnë nga masat e propozuara, e njëjta vlen për të rinjtë e përfshirë në skemat e bursave për studime në universitete të huaja, me mbështetje nga emigrantët e Kosovës të cilët dëshirojnë të natyralizohen në Kosovë si pjesëtarë të Diasporës së Kosovës. Në këtë drejtim, dobia e tyre për shoqërinë kosovare pasi të kthehen nga studimet mund të jetë shtytje e mëtejme për ekonominë dhe zhvillimin e vendit.

## **7. Vlerësimi i ndikimit në grupet e cenueshme**

Propozimi i përmirësimit të legjislacionit me masa të tjera do të ketë ndikim të dobishëm te grupet e cenueshme sidomos te pjesëtarët e grupeve etnike, gjegjësisht romët dhe ashkalinjtë, si dhe të tjerët. Reforma e propozuar, duke përfshirë trajnimin për një bazë adekuate të njohurive do të ofrojë mekanizma dhe procedura të standardizuara për çështjet që lidhen me mundësitë e barabarta edhe për individët që nuk gëzojnë të drejta e të cilët dëshirojnë të materializojnë të drejtën e tyre ligjore në fushën e shtetësisë (analfabetë, persona me aftësi të kufizuara fizike, pamundësi për të përdorur shërbimet në internet ose aplikacionet e telefonave celularë etj).

## **8. Mbrojtja e të dhënave**

Mbrojtja e të dhënave, për shkak të natyrës ligjore është një e drejtë që lidhet me të drejtën e privatësisë. Në këtë drejtim, autoritetet kompetente janë të detyruara të respektojnë standardet e përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Zyrat komunale të gjendjes civile duhet të kenë qartësi lidhur me atë se cila njësi e brendshme është përgjegjëse për menaxhimin, grumbullimin, përpunimin, duke përfshirë edhe kontrollin. Rrjedhimisht, kontrolli i ligjshmërisë së autoritetit të instancës së parë, si dhe definimi i kompetencave ndërmjet ARC dhe DSHAM në mbikëqyrjen e të dhënave për shtetësinë, përkatësisht nevoja për ndryshimet organizative duke transferuar përgjegjësitë e mbikëqyrjes nga ARC në DSHAM, justifikohet saktësisht nga standardet e mbrojtjes së të dhënave.

### Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Duke qenë se të gjitha të dhënat të cilat ndërlidhen me fushën e shtetësisë, janë të rlefektuara në kuadër të bazës së të dhënave në rradhë të parë regjistrin gjendor të shtetasve, pastaj edhe në kuadër të Bazës së të Dhënave të DSHAM, Grupi Punues dhe ekspertët e angazhuar në zhvillimin e Koncept Dokumentit kanë pasur qasje të plotë në të dhëna. Poashtu bashkëpunimi me akterët relevant në ofrimin e informatave ka qenë në nivel të kënaqshëm sidomos në fazën e përkufizimit të problemit dhe elaborimit të opsioneve më të përshtatshme për avancimin e kornizës ligjore dhe institucionale në fushën e shtetësisë.

## Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Gjatë fazës së hartimit të këtij Koncept dokumenti janë përfshirë në grup punues të gjithë akterët relevantë në fushën e shtetësisë, të cilët kanë dhënë kontribut në hartim. Pas finalizimit të draftit të koncept dokumentit, i njëjti është dërguar për konsultime paraprake tek të gjitha institucionet relevante. Komente në konsultimet paraprake janë dërguar vetëm nga Sekretaritari Koordinues i Qeverisë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Gjithashtu, ky koncept dokument është dërguar për konsultime publike në Platformën për konsultime nga data 26.11.2021 deri me datë 17.12.2021, dhe nuk ka pasur asnjë koment.

Figura7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit synon të përfshijë të gjithë institucionet relevante dhe palët tjera të interesuara në procesin e rregullimit ligjor të fushës së shtetësisë. Për këtë arsye, që nga fillimi i hartimit të këtij KD, në grup punues janë përfshirë institucionet relevante në fushën e shtetësisë, si dhe KD është dërguar për konsultime paraprake dhe konsultime publike në mënyrë që të gjithë palët e interesuar, duke përfshirë edhe qytetarët të qytetarët, të japin komentet e tyre për këtë draft,					
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati Kohor	Personi përgjegjës
Konsultimet paraprake me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Dërgimi i KD në emailar e institucioneve relevante për konsultime paraprake.	Janë pranuar komente nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë, dhe janë inkorporuar në draft të KD.	18.11.2021 – 25.11.2021	
Konsultimi publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik	Nuk ka pasur asnjë koment në draftin e KD.	26.11.2021 – 17.12.2021	Liridon Neziri

## Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Në kuadër të këtij kapitulli janë paraqitur planet për zbatimin e opsioneve dhe një analizë krahasimore në mes të opsioneve përmes së cilave synohet të justifikohet përzgjedhja e opsionit të preferuar i cili në mënyrë më efikase do të adresoj problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e identifikuara.

### Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Siç është elaboruar në kuadër të Kapitullit III, Opsioni 2 synon adresimin e problemit kryesor duke përfshirë shkaqet dhe efektet, pa ndërhyrje ligjore, por përmes zbatimit më efektiv të legjislacionit ekzistues. Në këtë drejtim në kuadër të këtij opsioni është propozuar zhvillimi i një programi për ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët të cilët merren me zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shtetësisë, rishikimin funksional të institucioneve përgjegjëse duke i bartur përgjegjësi autoritetit kompetent (DSHAM) në kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në nivel lokal, ofrimin e lehtësirave administrative për regjistrimin e lindjeve, organizimin e fushatave senzibilizuese për realizimin e të drejtave për kategori të cenueshme etj. Zbatimi i këtij opsioni ka implikime buxhetore dhe administrative por siguron dinamikë më të shpejtë të implementimit të masave të propozuara përkatësisht adresimit të defekteve të identifikuara, sidomos sa i përket kontrollit dhe mbikëqyrjes, kapaciteteve profesionale në nivel lokal etj.

Për më tepër në kuadër të këtij opsioni janë paraqitur këto rekomandime të cilat do të ndikonin në përmirësimin e zbatimit përmes masave jo rregullative:

- 1. Ndërtimi i kapaciteteve për të zhvilluar bazën e njohurive për çështjet e shtetësisë** - ndërlikueshmëria e ligjeve dhe akteve nën-ligjore për shtetësinë, së bashku me të drejtën ndërkombëtare dhe traktateve, praktikën gjyqësore, ndërlidhjen me standardet e mbrojtjes së të dhënave, statistikën, sigurinë, bashkëpunimin ndër-qeveritar me institucionet e tjera, implikojnë nevojën për njohuri të nivelit të lartë që kërkohet nga stafi profesional. Stafi i mirë-trajnuar është parakusht për kapacitetin e shtetit në këtë sferë dhe paraqet gjithashtu mbrojtje shtesë për shërbimin ndaj qytetarëve. Veçanërisht në kuptimin e epokës së digjitalizimit të ardhshëm në administratën publike, njohuritë profesionale të punonjësve përfitojnë për të gjetur zgjidhje inovative për të përmirësuar shërbimin në mënyrë transparente.
- 2. Zhvillimi i kurrikulit të trajnimit**, në bashkëpunim të ngushtë me botën akademike, duhet të trajtohet me prioritet në kuadër të zhvillimeve të cilat lidhen me fushën e shtetësisë. Për më tepër, duke pasur parasysh modelet e Institucioneve të Drejtësisë, të cilat zakonisht mbështeten nga UNHCR (kryesisht synojnë vetëm pashtetësinë, refugjatët dhe PZHBV-të), gjithashtu mund të jetë një mundësi për të tërhequr studentë për fushat aktuale të lidhura me shtetësinë: një model pilot mund të zhvillohet p.sh. në bashkëpunim me Avokatin e Popullit dhe Fakultetin Juridik, bazuar në Memorandum Bashkëpunimi duke u ofruar studentëve raste praktike që mund të japin një pasqyrë të dimensionit të shumëfishtë të shtetësisë. Programi i kurrikulës duhet të zhvillohet në formën e rregullores të miratuar nga Ministri i Punëve të Brendshme. Programi, nëse zgjerohet edhe p.sh. në Procedurën e Drejtës Administrative që mund të zhvillohet së bashku me Institutin e Administratës Publike, gjithashtu mund të konsiderohet përfshirja e çështjeve të cilat ndërlidhen me migracionin në kurrikulin e përgjithshëm të trajnimit.
- 3. Politikat e Migrimit:** migrimi ka të bëjë me emigracionin dhe imigracionin: sipas statistikave duket se emigracioni për shoqërinë kosovare është domosdoshmëri për një kohë të gjatë. Rekomandohet shumë që në dokumentet e politikave strategjike në fushën e migrimit t'i shtohet gjithashtu një pjesë që do të mbulojë shtetësinë. Duke pasur parasysh madhësinë e shtetit dhe se një pjesë e madhe e popullsisë jeton jashtë vendit, është e rekomandueshme që të mbulohet edhe kjo pjesë me masa se si të forcohen kontaktet, të ketë statistika cilësore, të planifikohen politika adekuatë në këtë fushë edhe në lidhje me strategjitë e kthimit. Nga ana tjetër, edhe imigracioni meriton masa për monitorim të trendit me statistika të sakta, si dhe me zhvillimin e masave të përshtatshme të integritimit që do të kontribuojnë në një qytetari të informuar mirë dhe të përgjegjshme në rast se bëheni shtetas. Rekomandohet bashkëpunim i fortë ndër-institucional me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ta zëmë, nëse takimet me emigrantët e Kosovës supozohet të organizohen në vendet ku ata punojnë, një përfaqësues i Divizionit për Shtetësi duhet të udhëtojë në delegacion në mënyrë që të sigurojë këshillim të duhur (kushtet për natyralizimin e bashkëshortit të huaj në rast kthimi, kushtet për regjistrimin e shtetësisë së fëmijëve në shtëpi, lirimi i shtetësisë etj.) Një projekt i veçantë i përshtatur rreth këshillimit për emigrantët jashtë vendit mund të hartohet në bazë të planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë së Migrimit 2021-2025.
- 4. Masat organizative:** Divizioni për Shtetësi në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim duhet të ketë përgjegjësi të qarta lidhur me mbikëqyrjen e punës së zyrtarëve në zyrat e gjendjes civile në nivelin komunal, gjithashtu për sa i përket marrjes së vendimeve lidhur me procedurat administrative të iniciuara me qëllim të regjistrimit të shtetësisë në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile (e cila deri më tani është kompetencë e Agjencisë së Regjistrimit Civil). Një strategji afatgjatë mund të parasheh zhvillimin e proceseve bazuar në Teknologji Informative, prandaj Kosova duhet të ketë në të ardhmen e afërt e-regjistrin e popullsisë, duke përfshirë evidentimin dhe gjurmimin e të gjitha proceseve që lidhen me shtetësinë (fitimi i shtetësisë përmes mënyrës së natyralizimit, humbja

## Koncept Dokumenti për Shtetësi

e shtetësisë, si dhe regjistrimi bazuar në dispozitat kalimtare e cila nuk është e kufizuar sipas ndonjë afati), i cili natyrisht duhet të bazohet në parimet e mbrojtjes së të dhënave. Në këtë drejtim, autoriteti kompetent përgjegjës për fushën e shtetësisë, duke ndjekur parimin e ligshmërisë, duhet të ketë edhe mandatin për të mbikëqyrur dhe kontrolluar të gjitha fazat e proceseve në lidhje me çdo mënyrë të fitimit, humbjes ose regjistrimit të shtetësisë.

5. Qeveria e Kosovës po përgatit Reformën e Administratës Publike, e cila bazohet në parimin e llogaridhënies dhe efikasitet më të lartë të shërbimeve, për qëllime publike, si dhe për t'i shërbyer qytetarëve me një sistem modern, duke përdorur gjithashtu teknologjinë e informacionit. Duke pasur parasysh faktin që MPB-DSHAM, dhe zyrat komunale të gjendjes civile lëshojnë dhe përpunojnë shumicën e dokumenteve administrative për qëllime të ndryshme (administratë publike, qëllimet e të drejtës civile, sigurinë e shtetit, lëshimi i dokumenteve të identitetit, pasaportave etj.) Është shumë e rekomandueshme që të fuqizojnë bashkëpunimin dhe koordinimin në nivelin e punës në mënyrë që të përcaktojnë masat e përshtatura për nevojat e sektorit.

Figura 8: Plani i zbatimit për Opsionin 2

Qëllimi i politikës	Lehtësimi i procedurave për kategori të veçanta juridike dhe parandalimit të pashtetësisë.							Shifra e kostos së pritur	
Objektivi strategjik	Harmonizimi i mëtutjeshëm i legjisllacionit dhe avancimi i kapaciteteve institucionale në fushën e kontrollit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të legjisllacionit në fushën e shtetësisë.								
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës.								
Objektivi Specifik 1	Outputi 1.1		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Fuqizimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjisllacionit në fushën e shtetësisë;	Mekanizmi efikas i kontrollit dhe mbikëqyrjes në nivelin qendror	Aktiviteti 1.1.1. Rishikimi funksional al në nivel vertikal dhe horizontal i institucioneve përgjegjëse në fushën e shtetësisë.	x					DSHAM, ARC	
		Aktiviteti 1.1.2. Miratimi i të gjeturave dhe rekomandim-		x				DSHAM	

Koncept Dokumenti për Shtetësi

		-eve nga procesi i rishikimit funksional.							
		Aktiviteti 1.1.3. Ri-organizimi institucional në nivel qendror në raport me mbikëqyrjen e Zyrave Komunale për Gjendje Civile lidhur me përgjegjësitë në fushën e shtetësisë.		x					DSHAM, DL, ARC
		Aktiviteti 1.1.4. Organizimin e fushatave senzibilizuese për realizimin e të drejtave për kategori të cenueshme.		x	x				DSHAM, ZIP
		Aktiviteti 1.1.5. Ofrimi i lehtësirave administrative për regjistrimin e lindjeve.	X						ARC, DSHAM
Objektivi Specifik 2	Output2.1		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Ngritja e kapaciteteve për të zhvilluar bazën e	Kapacitete profesionale të zhvilluara	Aktiviteti 2.1.1 Vlerësimi i nevojave për	x					DSHAM, ARC, IKAP	

Koncept Dokumenti për Shtetësi

njourive profesionale në zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shtetësisë	stafin në nivel qendror dhe lokal në fushën e shtetësisë.							
	Aktivitetit 2.1.2  Zhvillimi i Programit për ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët përgjegjës për zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shtetësisë.	x					DSHAM, ARC, IKAP	
	Aktiviteti 2.1.3 Organizimi i trajnimeve, punëtorive dhe programeve për shkëmbimin e përvojave dhe njourive në fushën e shtetësisë.		x				DSHAM, ARC, IKAP	
	Aktiviteti 2.1.4 Zhvillimi i kurrikulës sëtrajnimeve në fushën e shtetësisë.			x			DSHAM, ARC, IKAP	
	Aktiviteti 2.1.5 Zbatimi i një pilot-projekti përmes së cilit iu mundësohet studentëve			x			MPB, UP, Avokati i Popullit	

Koncept Dokumenti për Shtetësi

		raste praktike që mund të japin një pasqyrë të dimensionit të shumëfishtë të shtetësisë.							
Objektivi Specifik 3	Outputi 3.1 Regjistri		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Avancimi i sistemit qendror të shtetasve dhe zhvillimin e procedurave bazuar në Teknologji Informativ	Qendror i Shtetasve kredibil, i avancuar dhe i sigurtë	Aktiviteti 3.1.1 Rishikimi i procedurave dhe modaliteteve aktuale të futjes së të dhënave në Regjistrin Qendror të Shtetasve.	x					ARC	
		Aktiviteti 3.1.2 Auditimi i të gjitha Zyrave Komunale për Gjendje Civile nëçështjet të cilat lidhen me fushën e shtetësisë.		x				ARC	
		3.1.3 Hartimi i një Strategjie për të zhvilluar të gjitha procedurat në fushën e shtetësisë përmes Teknologjisë Informativ.			x			MPB	

		Aktiviteti 3.1.4 Zhvillimi i e- regjistrimit të popullsisë përfshirëvid entimin dhe gjurmimin e të gjitha proceseve që lidhen me shtetësinë.			x			MPB, ASK	
--	--	---	--	--	---	--	--	----------	--

Në anën tjetër Opsioni 3, në parim është komplementar me Opsionin 2, duke adresuar të gjitha shkaqet të cilat ndikojnë në problemin kryesor, njëkohësisht propozohet Ligji i ri për Shtetësi përmes së cilit synohet të harmonizohet legjislacioni në fushën e shtetësisë me praktikën dhe standardet që janë zhvilluar gjatë 12 viteve të fundit, me fokus në përkufizimin e saktë të Diasporës në kontekst të fushës së shtetësisë, evitimin e pashtetësisë duke përfshirë të drejtat e pakicave, dhe rregullat procedurale që përpiqen të thjeshtësojnë procedurat burokratike, si dhe për të siguruar standarde të larta profesionale në zbatimin e detyrave të autoritetit kompetent (DSHAM etj).Njëherit, ky është opsioni i preferuar i cili mbështetet nga Grupi Punues dhe bazohet në tërësi në analizën e situatës dhe të gjeturat nga diagnostifikimi i problemit kryesor, faktorëve të cilët e nxisin dhe efekteve që shkakton. Sa i përket dispozitave ligjore të cilat konsiderohet se duhet të ndryshohen, rekomandohet të ndryshohen këto dispozita:

- Neni 2 / 1- përkufizimi i shtetësisë në fund të formulimit që përfundon me detyrime, rekomandohet të ndryshohet duke shtuar edhe tekstin "dhe nuk tregon prejardhjen etnike të personit"; (në përputhje me përkufizimin në nenin 2/a të KESH-së);
- Neni 1.8 Përkufizimi i Diasporës të zëvendësohet nga: çdo person që banon ligjërisht jashtë Republikës së Kosovës i cili dëshmon se ka lindur në territorin e sotëm të Republikës së Kosovës, si dhe trashëgimtarët e tyre të kufizuar në brezin e parë, i cili i ka ruajtur lidhjet kulturore, familjare dhe ekonomike me Republikën e Kosovës janë anëtarë të Diasporës së Kosovës;
- Neni 16 - Natyralizimi i një anëtarë të Diasporës së Republikës së Kosovës: shqyrtimi i debatit publik i mbështetur nga një praktikë krahasuese mbi të cilën Shtetet po u japin shtetësinë e tyre emigrantëve që jetojnë përgjithmonë jashtë vendit, të cilët mbajnë tashmë shtetësinë e një vendi tjetër. Ligjet zakonisht kufizojnë qasjen deri në brezin e 3-të,ndërsa vendimi është çështje me interes specifik të shtetit, ndërsa për të shmangur vendime të mundshme arbitrare dhe jo transparente, përcaktohen kriteret për ekzistencën e një interesi kombëtar dhe veprimtarisë së individit që demonstroi nivelin e lidhjes së mirëfilltë me vendin. Rrjedhimisht, rekomandohet të ndryshohet formulimi i paragrafit 2 të nenit 16: Pjesëtar i Diasporës së Republikës së Kosovës është çdo person që banon ligjërisht jashtë Republikës së Kosovës që dëshmon se ka lindur në territorin e sotëm të Republikës së Kosovës, si dhe trashëgimtarët e tij, të kufizuar në brezin e parë, të cilët i ruajnë lidhjet kulturore, familjare dhe ekonomike me Republikën e Kosovës;
- Të shtohet një nen i veçantë për lehtësimin e natyralizimit të personave të cilët kanë imigruar nga viti 1999 nga qytetet: Preshevë, Medvegje dhe Bujanovc, me kërkesë, nëse ai/ajo përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 9 dhe nenin 10, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.3, 1.4 dhe 1.5 dhe qëndrimi i tyre në territorin e Republikës së Kosovës konsiderohet i ligjshëm;



- Të shtohet një neni i ri pas nenit 17: me titullin “Natyrizimi i personave të lindur në territorin e Republikës së Kosovës nga 1 janari 1988 deri më 1 janar 1998”. Me formulimin:
- *Personi i cili dëshmon se ka lindur në Kosovë në mes të 1 janarit 1981 dhe 1 janarit 1998, i cili nuk ishte banor i përhershëm i Kosovës më 1 janar 1998, mund ta fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës me kërkesë, nëse ai/ajo përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 9 dhe nenin 10, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.3, 1.4 dhe 1.5;*
- *Fëmija i rritur i personit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund ta fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës nëse i plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 9 dhe nenin 10, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.3, 1.4 dhe 1.5;*
- *Fëmija i mitur i personit të referuar në nën-paragrafin 1 mund ta fitojë shtetësinë nëse të dy prindërit bien dakord për natyrizim: në rast se fëmija është më i vjetër se 14 vjeç, duhet të parashtrohet pëlqimi me shkrim i fëmijës së bashku me kërkesën;*
- Neni 23-Garancia: të ndryshohet paragrafi 1 dhe të fshihet formulimi në fillim të fjalisë "Me kërkesë të shtetasit i cili kërkon lirim nga shtetësia" - garancia për nga natyra e saj është vendim procedural i veçantë që mbështet vendimet e formës së prerë derisa të plotësohet kushti i paraqitjes së provave të marrjes së shtetësisë së huaj dhe duhet të lëshohet *ex officio*: qëllimi i lëshimit të garancisë është shmangia e pashtetësisë, e cila është çështje e interesit publik dhe jo çështje e interesit personal;
- Neni 27: Regjistri i shtetasve: të shtohet pas paragrafit 5 një paragraf i ri 6 me formulimin: Regjistrimi i shtetësisë në regjistrin e shtetasve është subjekt i mbikëqyrjes së autoritetit kompetent (DSHAM/MPB). Të dhënat mbi shtetësinë mund të regjistrohen nga një zyrtar i cili ka kryer trajnim profesional për shtetësinë, trajnimi i ofruar nga programi i zhvilluar nga autoriteti kompetent (DSHAM/MPB) dhe e ka kaluar në provim, programi i trajnimit përcaktohet në akt nënligjor nga autoriteti kompetent. Trajnimi i tillë mund të jetë një pjesë e kurrikulës së përgjithshme të trajnimit gjatë shërbimit për të gjithë zyrtarët që kanë mandat të kryejnë cilëndo punë që ka të bëjë me shtetësinë;
- Neni 27 Duke pasur parasysh që ligji përcakton regjistrimin e shtetësisë vetëm me kërkesë të individit, dhe jo sipas detyrës zyrtare, rekomandohet që MPB të marrë në konsideratë mundësinë e regjistrimit të shtetësisë edhe me efekt *ex lege*, duke shtuar një paragraf në nenin ekzistues 27- kjo do të forconte kompetencat e MPB-së përkatsisht DSHAM-it lidhur me mandatin, gjithashtu e ndërlidhur me deklaratën sipas detyrës zyrtare në rast të ripranimit, dhe për këtë qëllim, regjistrimi i shtetësisë për rastet kur shtetësia supozohet sipas Ligjit për Ripranim. Zgjidhja e tillë do të ishte në përputhje me parimin e ligjshmërisë sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave.
- Të shqyrtohet mundësia e plotësim-ndryshimit të **Ligjit për Ripranim** - Duke pasur parasysh që Ligji për Ripranim hyri në fuqi vitin 2010, përpara ndryshimit të Ligjit për Shtetësinë dhe përafrimit të tij me Kushtetutën, neni 4 (i cili përcakton akoma numërimin e neneve me ligjin për shtetësinë nga 2008), duhet të rregullohet me numërimin në ligjin aktual : neni 31 dhe neni 32.
- Akti nënligjor sipas nenit 16/paragrafi 4 “Udhëzimi administrativ për kriteret e përcaktimit të lidhjes së ngushtë familjare dhe ekonomike për pjesëtarët e diasporës së Republikës së Kosovës”. Duke qenë se ky Udhëzim Administrativ nuk është miratuar ende, një opsion i mundshëm do të ishte:
- Neni 1- Gjatë përcaktimit të përmbushjes së kushteve të lidhjes së ngushtë familjare dhe ekonomike, autoriteti kompetent i aplikon kriteret për ekzistencën e lidhjeve kulturore, familjare dhe ekonomike të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, kur vendosë për procedurën e natyrizimit të pjesëtarëve të Diasporës së Kosovës.
- Neni 2 (1) Një anëtar i Diasporës së Republikës së Kosovës ose pasardhësi i tij/saj i rritur deri në brezin e parë në vijë të drejtpërdrejt, mund të aplikojë për natyrizim, dhe duhet të provojë ekzistencën e lidhjeve kulturore, familjare dhe ekonomike me Republikën e Kosovës;

- (2) Lidhjet kulturore: Natyralizimi është i mundur nëse aplikuesi i përmendur në paragrafin e mësipërm demonstroi lidhje afatgjatë personale aktive me Republikën e Kosovës dhe të paktën pesë vjet lidhje aktive me Shoqatat për Diasporën ose organizatat e bashkatdhetarëve të Republikës së Kosovës, ose me Institucionet që veprojnë në këtë fushë për ruajtjen e kulturës dhe traditave në Kosovë që veprojnë nën Ministrinë e Kulturës së Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- (2.1) Aplikuesi së bashkë me kërkesën i bashkëngjet provat që konfirmon lidhjen e tij/saj aktive të referuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe provat me të cilat organizatat relevante konfirmojnë të paktën pesë vjet funksionimin aktiv të përmendur në paragrafin e dytë të kësaj Artikulli;
- (2.2) Opinioni për përmbushjen e kriterëve të përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni për të drejtën për pranim të shtetësisë së Republikës së Kosovës sigurohet nga organi shtetëror përgjegjës për bashkëpunim me diasporën e Kosovës jashtë vendit, dhe Ministrinë e Kulturës nëse aplikuesi bashkëpunon me institucionet kulturore të Republikës së Kosovës. Nëse organi kompetent për Diasporën (MPJD) ose Ministria e Kulturës kanë nevojë për informata shtesë në lidhje me aplikuesin, ata e kërkojnë atë nga misioni kompetent diplomatik dhe konsullor i Republikës së Kosovës përmes shërbimit të brendshëm konsullor të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme me juridiksion mbi vendbanimin e kërkuarit, ose ia komunikojnë nevojën për informata shtesë përfaqësuesit ligjor të kërkuarit nëse përfaqësuesi i tillë është emëruar në përputhje me dispozitat e Procedurës për të Drejtën Administrative.
- (3) Lidhjet familjare (3.1) Natyralizimi është i mundur nëse aplikuesi dëshmon mbajtjen e lidhjeve me anëtarët e familjes së vijës së drejtpërdrejt: bashkëshort, prindër dhe fëmijët që jetojnë në Kosovë;
- (3.2) Aplikuesi duhet t’ia bashkëngjet kërkesës provën e ekzistencës së marrëdhënies familjare, duhet ta parashtrojë certifikatën e lëshuar nga autoriteti kompetent i Republikës së Kosovës për lëshimin e certifikatave për gjendjen civile.
- (3.3) Aplikuesi duhet ta parashtrojë provën e mbajtjes së lidhjeve me anëtarët e familjes siç referohet në paragrafin 1 të këtij nën-paragrafi, duke parashtuar provën se ai/ajo i përmbushë detyrimet ligjore ndaj anëtarëve të familjes që banojnë në Republikën e Kosovës siç përcaktohet nga *Detyrimet e së drejtës familjare* dhe të konfirmohet nga Zyra për Punë Sociale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- (4) Lidhjet ekonomike: (4.1) Natyralizimi është i mundur nëse aplikuesi, duke parashtuar me aplikacion për natyralizim, dëshmon provën për bashkëpunim aktiv ekonomik me kompanitë në Republikën e Kosovës, qoftë me themelimin e një kompanie që operon në Kosovë e regjistruar në regjistrin e bizneseve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, sigurimin e mundësive të punësimit për popullatën dhe investimet në ekonomi, ose sigurimin e fondeve për tarifën e shkollimit për arsim (bursën) e studentëve nga Republika e Kosovës në Universitetet e huaja.
- (4.2) Gama e investimeve në bashkëpunimin ekonomik siç është referuar në nenin e mëparshëm duhet të konfirmohet nga Ministria përgjegjëse për Ekonominë në formë të një deklarate me shkrim. Prova e pagesës për shkollim e mbuluar nga aplikuesi për studentët e Kosovës në Universitete të huaja është transferimi bankar në llogarinë e Universitetit të huaj me përkthim të legalizuar.

Figura9: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i politikës	Lehtësimi i procedurave për kategori të veçanta juridike dhe parandalimit të pashtetësisë.	Shifra e pritshme e kostos
Objektivi strategjik	Harmonizimi i legjislacionit dhe avancimi i kapaciteteve institucionale në fushën e kontrollit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e shtetësisë.	
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës.	

Koncept Dokumenti për Shtetësi

Objektivi specifik 1	Outputi 1.1							Institucioni /departamenti përgjegjës	
		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5			
Fuqizimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes sëzbatimit të legjislacionit në fushën e shtetësisë	Mekanizëm efikas i mbikëqyrjes në nivel qendror	Aktiviteti 1.1.1 Ligjit i ri për Shtetësi.	x					DSHAM, DL	
		Aktiviteti 1.1.2 Konsultimi me shoqërinë civile dhe publikun lidhur me Ligjin e ri për Shtetësi.	x					DSHAM, DL	
		Aktiviteti 1.1.3 Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ për kriteret e përcaktimit të lidhjes së ngushtë familjare dhe ekonomike për pjesëtarët e diasporës së Republikës së Kosovës.		x				DSHAM, DL	
		Aktiviteti 1.1.4 Harmonizimi i Legjislacionit sekondar		x				DSHAM, DL	

		me Ligjin e ri të Shtetësisë.							
		Aktiviteti 1.1.5  Plotësim-ndryshimi i Rregullorespër Organizimin e Brendshëm të MPB-së për të reflektuar ri-organizimin në raport me mbikëqyrjen e Zyrave Komunale për Gjendje Civile lidhur me përgjegjësitë në fushën e shtetësisë.		x				DL	
Objektivi specifik 2	Outputi 2.1		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Ngritja e kapaciteteve për të zhvilluar bazën e njohurive profesionale në zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shtetësisë	Zyrtarët përgjegjës për fushën e shtetësisë në nivel qendror dhe lokal të trajnuar për të zbatuar dispozitat e reja të ligjit të shtetësisë	Aktiviteti 2.1.1  Trajnimi dhe certifikimi i zyrtarëve të cilët trajtojnë lëndët e shtetësisë në nivel qendror dhe lokal lidhur me zbatimin e		x				DSHAM, ARC, IKAP	

Koncept Dokumenti për Shtetësi

		dispozitive të reja të Ligjit të Shtetësisë.							
		Aktiviteti 2.1.2  Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për zyrtarët në nivel qendror dhe lokal të cilët merren me zbatimin e Legjislacionit të Shtetësisë.		x					DSHAM, ARC
		Aktiviteti 2.1.4  Hartimi i Rregullores përmes së cilës miratohet kurrikula e trajnimeve në fushën e shtetësisë.			x				DSHAM, ARC, IKAP
Objektivi specifik3	Output3.1		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Avancimi i sistemit qendror të shtetasve dhe zhvillimin e procedurave bazuar në Teknologji Informative	Rritja e efikasitetit të shqyrtimit të lëndëve	Aktiviteti 3.1.1  Studimi i fizibilitetit për përshtatshmërinë e sistemit për të		x	x			ARC, DTI, DSHAM	

		<p>mundësuar zhvillimin e procedurave bazuar në Teknologji Informative.</p> <p>Aktiviteti 3.1.2</p> <p>Hartimi i Udhëzimit Administrativ/Rregullores përmes së cilës përcaktohen procedurat për zhvillimin e procedurave bazuar në Teknologji Informative.</p>						
		<p>Aktiviteti 3.1.3</p> <p>Zhvillimi i e-regjistrimit të popullsisë.</p>			x			ARC, DTI ASK
		<p>Aktiviteti 3.1.4</p> <p>Trajnimi në fushën e mbrotjes së të dhënave personale përgjatë zhvillimit të procedurave bazuar në teknologji informative.</p>			x			ARC, DSHAM

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Në kuadër të Kapitullit 3 dhe nën-Kapitullit 6.1 janë elaboruar opsionet e ndryshme me qëllim të adresimit të problemit kryesor duke përfshirë shkaqet dhe pasojat. Ndërsa në këtë kapitull në formë tabelare është paraqitur një analizë krahasimore e tre opsioneve të elaboruara në këtë Koncept Dokument përkatësisht 1. Opsioni për ruajtjen e status quo-s; 2). Opsioni për fuqizimin e zbatimit përmes masave institucionale, politike, investimeve në teknologji dhe ngritjes së kapaciteteve, porpa ndërhyrje ligjore; 3). Opsioni i cili komplementon opsionin e dytë për fuqizimin e zbatimit por shkon një hap tutje duke propozuar plotësim-ndryshimin e Ligjit për të harmonizuar me praktikën e zhvilluar në 12 viteve e fundit, përkufizimin e Diasporës, ri-organizimit institucional me qëllim të mbikëqërjes efektive etj. Përtej pjesës narrative të prezentuar në nën-Kapitullin 6.1, në analizimin e opsioneve është përdorur modeli i analizës shumë-kritereshe duke u bazuar në këto elemente: 1). Kosto; 2). Efikasiteti i implementimit; 3). Shkalla e harmonizimit me standarde ndërkombëtare; 4). Ndikimi në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Sa i përket kostos, Grupi Punues ka konkluduar se në opsionin e parë përkatësisht nëse vazhdon të mos merret asnjë veprim nuk do të implikonte kosto shtesë për dallim nga Opsionet 2 dhe 3 në kuadër të të cilave janë paraparë masa implementuese, avancime teknologjike dhe ndryshime ligjore të cilat bartin kosto financiare. Sidoqoftë, kostoja e Opsioneve 2 dhe 3 do të ekonomizohej në një të ardhme të afërt si rezultat i adresimit të defekteve aktuale në sistemin qoftë si rezultat i përfundimit nga skemat sociale dhe pensionale të atyre të cilët nuk kanë plotësuar kriteret por janë natyralizuar dhe tani gëzojnë këto të drejta, qoftë edhe nga përfshirja e kategorive të caktuara juridike të cilët do të kishin ndikim në zhvillim e vendit.

Padyshim se efikasiteti i implementimit do të përmirësohej nëse bëhën ndryshimet e propozuara ligjore dhe investimet në teknologjinë informative përmes së cilave mundësohet zhvillimi i procedurave online dhe në një formë më efektive por gjithësesi transparente. Poashtu, Opsioni 3 siguron harmonizimin e Ligjit për Shtetësinë me praktikën gjyqësore dhe standardet ndërkombëtare të zhvilluara së fundmi me fokus në çështjet e suksesionit të shteteve, parandalimit të pashtetësisë, mbrojtjes së kategorive të cënueshme etj.

Krejt në fund, nëse përfshihen rekomandimet e prezentuara në këtë Koncept Dokument në kuadër të Dispozitave ligjore të Ligjit të plotësuar-ndryshuar të Shtetësisë, padyshim se do të këtë ndikim në zhvillimin socio-ekonomik të vendit sidomos sa i përket përkufizimit dhe lehtësimit të natyralizimit të Diasporës dhe shfrytëzimit të potencialit njerëzor dhe kapitalit investiv të tyre në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në analizën krahasuese të paraqitur në pjesën narrative dhe tabelare të këtij Koncept Dokumenti, Grupi Punues konsideron se Opsioni 3 i cili komplementon masat implementuese të Opsionit 2 dhe shkon përtej duke bërë edhe ndërhyrje ligjore përkatësisht plotësim-ndryshimin e Ligjit të Shtetësisë, është opsioni i preferuar për të përmirësuar gjendjen dhe adresuar problemet e identifikuar në fushën e shtetësisë. Në këtë drejtim, Grupi Punues i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës të miratojë këtë Koncept Dokument bazuar në Opsionin 3 .

Figura 10: Krahasimi i opsioneve

<b>Mjeti i krahasimit: Analiza shumë-kritereshe</b>			
	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit	Opsioni 3: Ligji i Ri për Shtetësinë
Kosto	-	+	+
Efikasiteti i implementimit	-	+	++

Harmonizimi me standarde ndërkombëtare	-			-			+		
Ndikimi në zhvillimin socio-ekonomik të vendit	-			+			++		
<b>Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor</b>	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
	-	-	-	-	-	-	494,300	495,400	496,505
<b>Përfundimi</b>							Nuk krijon kosto shtesë buxhetore, pasi që të gjitha akitvitetet e parapara do të mbuloohen nga ndarjet buxhetore.		

## Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Duke marrë në konsideratë përkufizimin e problemit, shkaqet dhe pasojat, si dhe duke u bazuar nëelaborimin dhe analizën krahasuese të opsioneve të paraqitura në këtë Koncept Dokument, Grupi Punues ka rekomanduar Ligjit të ri për Shtetësinë. Njëherit, ky Opsion, nuk përjashton por është komplementar me masat implementuese të rekomanduara në Opsionin 2. Në këtë drejtim, Plani për zbatimin e opsionit të preferuar përfshin aktivitetet të cilat fokusohen në plotësim-ndryshimin e Ligjit për Shtetësinë, si dhe disa prej aktivitetëve kryesore të cilat orientohen drejt ngritjes së kapaciteteve, avancimit të teknologjisë dhe ri-organizimit institucional me qëllim të fuqizimit të kontrollit, mbikëqyrjes dhe llogaridhënies në fushën e shtetësisë.

Poashtu, Grupi Punues do të sigurohet të ketë një sinergji dhe koherencë në mes të aktivitetëve të propozuara në këtë Plan me dokumentet tjera planifikuese të Qeverisë përkatsisht Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Figura 11: Plani i zbatimit të opsionit të preferuar

Qëllimi i politikës	Lehtësimi i procedurave për kategori të veçanta juridike dhe parandalimit të pashtetësisë.							Shifra e pritshme e kostos
Objektivi strategjik	Harmonizimi i legjislacionit dhe avancimi i kapaciteteve institucionale në fushën e kontrollit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e shtetësisë.							
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës.							
Objektivi specifik 1	Outputi 1.1							
Fuqizimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes	Mekanizëm efikas i mbikëqyrjes	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	



Koncept Dokumenti për Shtetësi

së zbatimit të legjislacionit në fushën e shtetësisë	në nivel qendror	Aktiviteti 1.1.1 Ligjit i ri për Shtetësi.	x					DSHAM, DL		
		Aktiviteti 1.1.2 Konsultimi me shoqërinë civile dhe publikun lidhur me hartimin e Ligjit të ri për Shtetësi.	x					DSHAM, DL		
		Aktiviteti 1.1.3  Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ për kriteret e përcaktimit të lidhjes së ngushtë familjare dhe ekonomike për pjesëtarët e diasporës së Republikës së Kosovës.		x					DSHAM, DL	
		Aktiviteti 1.1.4 Harmonizimi i Legjislacionit sekondar me Ligjin e ri të Shtetësisë.		x					DSHAM, DL	
		Aktiviteti 1.1.5  Plotësim-ndryshimi i Rregullores për		x					DL	

Koncept Dokumenti për Shtetësi

		Organizimi-n e Brendshëm të MPB-së për të reflektuar ri-organizimin në raport me mbikëqyrje-n e Zyrave Komunale për Gjendje Civile lidhur me përgjegjësit-ë në fushën e shtetësisë.							
Objektivi specifik 2	Outputi 2.1		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Ngritja e kapaciteteve për të zhvilluar bazën e njohurive profesionale në zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shtetësisë	Zyrtarët përgjegjës për fushën e shtetësisë në nivel qendror dhe lokal të trajnuar për të zbatuar dispozitat e reja të ligjit të shtetësisë	Aktiviteti 2.1.1		x				DSHAM, ARC, IKAP	
		Trajnimi dhe certifikimi i zyrtarëve të cilët trajtojnë lëndët e shtetësisë në nivel qendror dhe lokal lidhur me zbatimin e dispozitave të reja të Ligjit të Shtetësisë.							
		Aktiviteti 2.1.2		x					DSHAM, ARC
		Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për zyrtarët në nivel qendror dhe lokal të							

Koncept Dokumenti për Shtetësi

		cilët merren me zbatimin e Legjislacionit të Shtetësisë.							
		Aktiviteti 2.1.3  Hartimi i Rregullorës përmes së cilës miratohet kurrikula e trajnimeve në fushën e shtetësisë.			x			DSHAM, ARC, IKAP	
Objektivi specifik3  Avancimi i sistemit qendror të shtetasve dhe zhvillimin e procedurave bazuar në Teknologji Informative	Output3.1  Rritja e efikasitetit të shqyrtimit të lëndëve		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
		Aktiviteti 3.1.1  Studimi i fizibilitetit për përshtatshmërinë e sistemit për të mundësuar zhvillimin e procedurave bazuar në Teknologji Informative.  Aktiviteti 3.1.2  Hartimi i Udhëzimit Administrativ /Rregullores përmes së cilës		x	x			ARC, DTI, DSHAM	

		përcaktohen procedurat për zhvillimin e procedurave bazuar në Teknologji Informative.						
		Aktiviteti 3.1.3  Zhvillimi i e-regjistrimit të popullsisë.			x			ARC, DTI ASK
		Aktiviteti 3.1.4 Trajnimi në fushën e mbrotjes së të dhënave personale përgjatë zhvillimit të procedurave bazuar në teknologji informative.			x			ARC, DSHAM

## Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Implementimi i opsionit të rekomanduar sipas planit të prezentuar në këtë Koncept Dokument do të bëhet në mënyrë tërëgjyesh dhe të strukturuar sipas Manualit dhe Udhëzimeve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ndërsa, 5 vite pas plotësimit-ndryshimit të Ligjit për Shtetësi do të bëhet vlerësimi ex-post i Ligjit për Shtetësi.

### Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit
		Po	Jo		

Koncept Dokumenti për Shtetësi

Vendet e punës <sup>41</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	x		u	u
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x	u	u
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		x	u	u
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x	u	u
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		x	u	u
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		x	u	u
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		x	u	u
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		x	u	u
	A do të krijohen biznese të reja?	x		u	u
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënjes së informatave të reja?		x	u	u
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënjes së informatave për bizneset?		x	u	u
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		x	u	u
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		x	u	u
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		x	u	u
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		x	u	u
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?	x		u	u
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		x	u	u
	A do të rriten investimet nga diaspora?	x		L	L
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		x	u	u
	A do të rriten investimet e huaja direkte?	x		L	L
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		x	u	u
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		x	u	u
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		x	u	u

<sup>41</sup>Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

Koncept Dokumenti për Shtetësi

	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		x	u	u
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		x	u	u
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		x	u	u
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x	u	u
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x	u	u
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x	u	u
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x	u	u
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		x	u	u
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		x	u	u
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?	x		L	L
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x	u	u

## Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimetshoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit
		Po	Jo		
Vendet e punës <sup>42</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	x		u	u
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x	u	u
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		x	u	u
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x	u	u
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		x	u	u
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		x	u	u
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		x	u	u
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		x	u	u
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		x	u	u
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		x	u	u
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?	x		u	u
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?	x		u	u
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		x	u	u

<sup>42</sup>Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

Koncept Dokumenti për Shtetësi

Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?	x		u	u
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		x	u	u
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		x	u	u
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		x	u	u
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?	x		u	u
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	x		u	u
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	x		L	L
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		x	u	u
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		x	u	u
Shëndeti dhe siguria publike <sup>43</sup>	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		x	u	u
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		x	u	u
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		x	u	u
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		x	u	u
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		x	u	u
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		x	u	u
	Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?	x		u
A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		x		u	u

<sup>43</sup>Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.



## Koncept Dokumenti për Shtetësi

	A ndikon në nivelet e korrupsionit?	x		L	L
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	x		L	L
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		x	u	u

## Shtojca3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		x	u	u
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		x	u	u
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		x	u	u
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		x	u	u
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		x	u	u
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		x	u	u
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		x	u	u
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		x	u	u
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		x	u	u
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		x	u	u
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		x	u	u
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		x	u	u
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		x	u	u
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?		x	u	u
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		x	u	u
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		x	u	u
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		x	u	u

Koncept Dokumenti për Shtetësi

	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		x	u	u
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		x	u	u
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		x	u	u
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		x	u	u
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		x	u	u
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		x	u	u
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		x	u	u
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		X	u	u
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		X	u	u
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		x	u	u

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit
		Po	Jo		
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?	x		u	u
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?	x		u	u
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?	x		u	u
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?	x		u	u
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?	x		u	u
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		x	u	u
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		x	u	u
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		x	u	u

Koncept Dokumenti për Shtetësi

Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	x		L	L
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	x		L	L
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	x		u	u
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?	X		u	u
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?	X		u	u
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		x	u	u
Trajtimi i barabartë <sup>44</sup>	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	x		u	u
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		x	L	L
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		x	u	u
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?	x		L	L
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		x	L	L
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?	x		L	L
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		x	u	u
	A ndikohet qasja në drejtësi?		x	u	u

<sup>44</sup>Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*